

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Eri MURATI
Zv/kryeredaktorë - Rezarta DELISULA - Tedi BLUSHI
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXIII - Nr. 7536 E martë 22 Maj 2017 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion i Ditës

Në Selanik të Greqisë, nacionalistë të majtë e të djathtë rrahën kryetarin e bashkisë së qytetit, Janis Butaris. Një burrë i mençur dhe trim, që vite tashmë i kundërvihet...
Vijon në faqen 21

Nga GAZMEND KAPLLANI

Koncerti i ufologut fashist grek, ofendim për shqiptarët



Opinion i Ditës

Nga XHEVAT MUSTAFA

Për merita apo për mëshirë?

Hapja e negociatave të pranimit në HBE ishte e vazhdon të jetë një nga sfidat më të forta për politikën shqiptare në përgjithësi, e veçanërisht për qeveritë "Rama 1...
Vijon në faqen 20



Tensione në Kuvend, PD: Kemi përgjim tjetër rrënues

"Xhafaj", Rama: Nëse audio-përgjimi është i vërtetë, do të rishikoj pozicionin

Kryeministri: Nëse prokuroria i shkon në fund, do të shikohet diçka tronditëse. PD në prokurori: Hetimi i marrë peng nga qeveria

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se, nëse audio-përgjimi i publikuar për vëllain e ministrit Fatmir Xhafaj del i vërtetë, atëherë ai do të rishikojë pozicionin e tij. Por, nga ana tjetër, Rama tha se në rast se prokuroria del në përfundim se video nuk është autentike, por e montuar, atëherë ata që e kanë bërë një...
Në faqet 2-4

BOTOHET NE FLETOREN ZYRTARE REGJISTRI I VENDIMEVE PER VITET 1993-1997

ATP: PRONARET, LISTA E RE ME 300 PERFITUES

Agjencia e Kthimit e Kompensimit: Përfituesve u është njohur e drejta për kompensim. Mangësitë apo problematikat do jepen të detajuara në dosje



(Në foto) Agjencia e Trajtim të Pronave

Në faqet 12-13

REVOLTA E SPAÇIT

Meta: Përmendore në kujtim të viktimave të diktaturës, Vlahutin: Donin të ishin në Europë

Në faqen 5

KUSH PËRFITON

Qeveria, 2 miliardë lekë kompensim për pronarët që preken nga ndërtimet informale

Në faqen 4

PYJET NË DIBËR

Një resurs i neglizhuar nga qeveria dhe qushteti lokal, dje dhe sot!

Në faqen 11

FLET MINISTRI

Shtyhet taksa e pronës, Ahmetaj: Do të paguhet në vitin 2019, ja arsye

Në faqen 6

FORMULARI TIP



Pronarët në Vlorë, ATP merr në shqyrtim 2400 dosje, lista e parë me përfituesit në qark

Në faqet 15-18

Rektori: Një numër i konsiderueshëm maturantësh janë pararegjistruar në këtë institucion elitari

"Luarasi", Ethem Ruka: Programe studimi që i nevojiten tregut

Fakultet të ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit

Nga VOLTIZA DURO

Kolegi Universitar "Luarasi" do të çelë Fakultetin e ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit për të gjithë studentët që do të fillojnë studimet në vitin akademik 2018-2019. Hapja e tri departamenteve të reja i



INTERVISTA

jep këtij institucioni arsimor elitari statusin e universitetit, duke qenë i vetmi që ofron këtë fakultet në vend. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", rektori i "Luarasit", prof. dr. Ethem Ruka tregon se qëllimi i universitetit është të ofrojë programe...
Në faqet 10-11

SKANDALI "XHAFAJ" HETIMI

Deputeti Alibeaj, përfaqësuesi i viktimave të trafikimit të narkotikëve

Audio-përgjimi, PD në prokurori: Hetimi, i marrë peng nga qeveria

Salianji, me pankartë që ironizon Agron Xhafajn

Valentina Madani

Tre zyrtarët demokratë, Ervin Salianji, Gazmend Bardhi dhe Enkelejd Alibeaj dhanë dje dëshminë e tyre në Prokurorinë e Krimeve të Rënda, lidhur me përgjimin e PD-së, ku pretendohet se Agron Xhafaj, vëllai i ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj është i përfshirë në trafikun e drogës. Deputeti Salianji mbante në duar një pankartë, ku ironizonte pretendimet e Agron Xhafajt se nuk është ai në audio-përgjim. Gjatë dëshmimeve para hetuesve, mësohet se deputetët nuk kanë dhënë sqarime për mënyrën se si e kanë siguruar përgjimin e pretenduar, ndërsa për mediat kanë folur me gjuhë politike për atë çfarë kanë deklaruar para prokurorëve. Eksperti ligjor i PD-së, Gazmend Bardhi qëndroi rreth 40 minuta para prokurorëve dhe në dalje ngrii shqetësimin se Prokuroria e Krimeve të Rënda nuk po e kryen detyrën siç duhet. Sipas tij, i pari që duhej të merrej në pyetje ishte Agron Xhafaj. "Jemi përpara një rasti të dokumentuar të abuzimit me pushtetin nga ministri i Brendshëm dhe qeveria për llogari të një veprimtarie kriminale të vëllait të ministrit të Brendshëm. Unë jam jurist dhe sigurisht që do të bashkëpunoj me organin e prokurorisë sa herë që të thotë, por nuk mund të rri dot pa shprehur shqetësimin tim që kjo është Prokuroria e Krimeve të Rënda, që ka përdetyrë të luftojë krimin e organizuar dhe trafikun e drogës dhe shtetasi i dyshuar si i përfshirë në trafik droge, që është vëllai i ministrit të Brendshëm, nuk është marrë i pari në pyetje, por jemi marrë ne që denoncojmë rastin. Prokuroria do të duhet të kishte sekuestruar këtë material privat, siç e quan kryeministri, sepse është një e dhënë që i ndihmon hetimet. Thirrja ime publike ndaj organit të prokurorisë është që



Tre zyrtarët demokratë, Ervin Salianji, Gazmend Bardhi dhe Enkelejd Alibeaj

ERVIN SALIANJI

"Në përgjimin është zëri i gazetarit Olldashi, 'bashkëpunëtorit X' Albert Veliu dhe i trafikantit tjetër, i cili është bashkëpunëtor apo zari i Agron Xhafajt ku flitet qartazi për '10 kile drogë mos më hajde, unë flas për 100 kile e sipër'", tha Salianji.



të fusë hetimet në drejtimin e duhur që i ngarkon ligji. Dhe drejtimi i duhur që i kërkon ligji është të ndëshkohen në mënyrë spektakolare individët e përfshirë në krim të organizuar dhe individët që bëjnë trafik droge. Rasti është publik, bëhet fjalë për vëllain e ministrit të Brendshëm", tha z. Bardhi. Deputeti Ervin Salianji mbërriti në prokurori me një pankartë

LSI i kërkon prokuror të nisë hetojë kryeministrin që mashtroi për audio-përgjimin, i cili sipas tij implikon vëllain e ministrit të Brendshëm në trafikun e drogës. Sipas kreut të grupit të LSI, Rama ka kryer hetime paralele në lidhje me audio-përgjimin, gjë që bie në kundërshtim me ligjin. "Përse kryeministri bën hetime? Bën edhe manipulime paralele. Sepse është një mashtrim paralel i mirëfilltë. Ekzekutivi nuk ka të drejtë të bëjë hetimet, nuk heton kryeministri. Nuk e kanë bërë as shtetet e diktaturës, të paktën për sy e faqe", tha z. Vasili. Kreu i deputetëve të LSI-së hodhi akuzat ndaj tij, ndërsa paralajmëroi se ka edhe të tjera pjesë të përgjimit. Deputeti Ervin Salianji qëndroi rreth dy orë përballë grupit hetimor. Ai sqaroi se akuzat nuk janë poli-

tike, pasi nga materialet shihet qartë përfshirja e Agron Xhafajt. "Në përgjimin që unë kam parë dhe disponohen nga ana e PD, që ka ardhur nga gazetari Jetimir Olldashi, shihet zëri i gazetarit Olldashi, 'bashkëpunëtorit X' Albert Veliu dhe i trafikantit tjetër, i cili është bashkëpunëtor apo zari i Agron Xhafajt ku flitet qartazi për '10 kile drogë mos më hajde, unë flas për 100 kile

HETIMI

Krimet e Rënda kanë marrë në pyetje të hënën (21 maj) gjithashtu edhe gazetarin Jetimir Olldashi, të cilin i është kërkuar që të paraqesë edhe aparaturnë me të cilën realizoi audio-përgjimin. Të premtën Prokuroria e Krimeve të Rënda mori edhe dëshminë e Albert Veliu, personit që pretendohet se ka kryer përgjimin, ndërsa tashmë mbetet që organi i akuzës të kërkojë një ekspertizë për zërat e personave në audio-përgjim.



Komisioni i Ligjeve gjatë mbledhjes së djeshme

GAZMEND BARDHI

"Nuk është marrë në pyetje ministri Xhafaj, që i lehtëson veprimtarinë kriminale vëllait. S'është marrë në pyetje akoma kryeministri, që ka krijuar një alibi publike ndaj vëllait të ministrit se gjoja zëri në materialin audio nuk është i Agron Xhafajt".

"Më 26 maj, protestë ndaj kryeministrit trafikant"

Audio-përgjimi, LSI: Prokuroria të hetojë, Rama nuk ka të drejtë të bëjë hetime



DEKLARATA

Z. Vasili tha se prokuroria duhet ta marrë në pyetje si dëshmitar Ramën, që ka deklaruar se ka kontaktuar një kompani për këtë material dhe ka marrë përgjigje se ai nuk është një material autentik.

ia, e cila nuk lëviz gishtin dhe i ka krijuar këtë komoditet kryeministrit, orë pas ore rëndom gjithmonë e më shumë pozitën e saj dhe po zhbën totalisht paansh-

mërinë e saj dhe integritetin e organit të akuzës. E vetmja që ka vënë perden e zezë syve është prokuroria shqiptare, e cila duhet ta heqë sa më parë për të shpëtuar në radhë të

parë veten e saj", u shpreh Petrit Vasili. Të gjitha këto sipas Vasilit janë arsye që qytetarët të dalin në protestë më 26 maj, për të vënë në vend drejtësinë.

etjen e dëshmitarëve. "Që sot dhe në vazhdim të jem përfaqësuesi i viktimave të këtij fenomeni kriminal. Që do të thotë, në bazë të parashikimeve ligjore, unë deputeti Enkelejd Alibeaj kam të drejtë të kërkoj thirrje dëshmitarësh, këqyrje, bërje aktesh, akte të tjera hetimore si një mundësi që procesi penal të mos merret peng nga Rama dhe Xhafaj", theksoi z. Alibeaj.



Sherri te "Ligjet" dhe "Ekonomia", nga delet te kasapi, nga kërcënimet te Babalja dhe karagozët

"Xhafaj", tension në Kuvend, PD: Kemi përgjim tjetër rrënues

Braçe: Doni pushtet me dhunë. Spahia: Jeni bërë palaço

Valentina Madani

Opozita paralajmëroi dje një tjetër përgjim, që implikon në trafikun e lëndëve narkotike Agron Xhafajn, gjatë kohës kur i vëllai i tij, Fatmir Xhafaj ishte ulur në karrigen e ministrit të Brendshëm. Deputetët e PD-së nuk kanë lejuar vijim normal të punimeve tek Komisioni i Ligjeve dhe ai i Ekonomisë, pasi sipas tyre qeveria duhet të japë shpjegime për vëllain e ministrit dhe aferat e tjera. Pas debatesh, PD-ja braktisi punën e komisionit. Tonet e ashpër dhe përplasjet verbale nuk munguan në Komisionin e Ligjeve, ku demokratët nuk lejuan vijimin normal të mbledhjes. Në debate u përfshirë deputeti e PD-së Oerd Bylykbashi, Gent Strazimir dhe Klevis Balliu me kryetarin e komisionit, Ulsi Manja. Ky i fundit nuk lejoi diskutime jashtë rendit të ditës. Në debate u përfshirë edhe deputeti Klevis Balliu, i cili iu drejtua Manjës se po sillej si karagoz, ndërsa kreu i 'Ligjeve' iu përgjigj se karagozin të shkojë dhe ta tregojë në vend tjetër. Edhe deputeti Bardh Spahia debatoi me Ulsi Manjën, duke kërkuar që komisioni të mos vijojë me diskutimet për temën e ditës, në një kohë që po flitet për një ngjarje kaq të rëndë. Por, Manja iu përgjigj se Komisioni i Ligjeve nuk është komisioni i Babales. Ndërkohë, e njëjta situatë ishte edhe tek Komisioni parlamentar i Ekonomisë. Edhe në Komisionin e Ekonomisë u vu re një prezencë e shtuar e deputetëve demokratë. PD paralajmëroi se së shpejti do të bëhet publik një tjetër përgjim rrëndues për pushtetarët socialistë. Deklarata e fortë erdhi nga deputeti Flamur Noka në Komisionin e Ekonomisë, ku të zgjedhurit demokratë nuk lejuan vijimin normal të mbledhjes. "Materiali i dytë që do dalë do jetë vërtetimi i faktit se Agron Xhafaj ishte aktiv në trafikun e drogës, kur vëllai i tij ishte ministër. Nëse të shtunën nuk largojmë ministrin e Brendshëm, bëhuni gati se do ju largojmë me gjithë kryeministrin", tha z.Noka. Por kjo deklaratë e Nokës e ndezi më shumë debatin në komision. Për kre-



Opozita duke braktisur dje Komisionin e Ekonomisë

BLLOKIMI

Mbledhja e djeshme e Komisionit të Ligjeve është zhvilluar mes debatesh të ashpër, pasi deputetët e opozitës nuk pranuan që punimet të zhvillohen normalisht. E njëjta situatë u përsërit edhe në Komisionin e Ekonomisë.

PËRPLASJA NË KOMISIONET KUVENDORE, DEBATI TE "LIGJET"

GENT STRAZIMIRI: Kalendari nuk përmban çështjen më të rëndësishme, si çështja "Xhafaj". Ka 10 dite me fakte e prova autentike. Po drejtohem nga një narkoqeveri me një narkokoperturë. Qeveria u kap me presh në duar.

OERD BYLYKBASHI: Ministri i Brendshëm ka mbrojtur vëllain kriminal, e paktoi dhe e çoi në Itali, ndërsa duhet të fillonte ndjekja penale për të, për trafik të lëndëve narkotike.

KLEVIS BALLIU: Z.Manja, mos bëj karagozin këtu.

ULSI MANJA: Karagozin shko dhe tregojë në vend tjetër.

OERD BYLYKBASHI: Ky komision nuk mund të vijojë më pa shkarkuar Fatmir Xhafajn. Sa kohë Fatmir Xhafaj është ministër i Brendshëm, mbron krimin në qeveri.

KLEVIS BALLIU: I keni nxjerrë të gjithë mafiozë, gazetarët, opozitën, ndërkohë që i keni mafiozët te partia juaj. Njërin e vratë në burg. Pasi i droguat, shqiptarët po i vrisni.

BARDH SPAHIA: E turpshme, bëheni palë me krimin, jeni bërë palaço.

ULSI MANJA: Si e kishte ai, "Babalja"?! Ti po më kërkon të mos bëj detyrën... Ky nuk është komisioni i "Babaljes", por është Komisioni i Ligjeve.

LUÇIANO BOÇI: Ulsi, je bërë si Gramozi.

BOÇI, FELAJT: Rregulloje Ulsin se ke qenë e marrëdhënies me parlamentin.

BARDH SPAHIA: Mysafirët e këtij komisioni nuk jam unë. Por kriminelët që sollët ju në parlament.

BYLYKBASHI: Xhafaj ka kontribut kryesor në mbushjen e burgut të Spaçit. Xhafaj është avokati më i mirë i krimin të organizuar.

FINO, BOÇIT: A zgjidhni gjë këtu? Se ne nuk kemi gjë në dorë. Bëni zhurmë këtu.

KLEVIS BALLIU: Dje mbronit Saimir Tahirin, sot e keni në arrest shtëpie. Jeni bërë palaço. Pse iku në Itali Agron Xhafaj?

DEBATI TE "EKONOMIA", PARALAJMËRIMI I PD-SË DHE KUNDËRPERGJIGJJA PËRMES KASAPIT

FLAMUR NOKA: Së shpejti një përgjim i ri, që provon se Agron Xhafaj vijonte trafikun e drogës gjatë kohës që vëllai i tij ka qenë ministër i Brendshëm. Largimi i Agron Xhafajt në Itali ishte një lëvizje dinake për t'u hedhur hi syve njerëzve. Materiali i dytë që do dalë, do jetë vërtetimi katarcipërisht i faktit se Agron Xhafaj ishte aktiv në trafikun e drogës, kur vëllai i tij ishte ministër. Nëse të shtunën nuk largojmë ministrin, bëhuni gati se do ju largojmë me gjithë kryeministrin.

ERION BRAÇE: Bujrum, merreni me dhunë pushtetin, si në vitin 1996. Kërcënimet janë të rënda në raport me ligjin.

FLAMUR NOKA: Përgjimi provon se Agron Xhafaj trafikonte drogë. Largimi i Agron Xhafajt ishte lëvizje dinake, për t'u hedhur hi syve njerëzve. Nëse nuk rrëzojmë ministrin, rrëzojmë kryeministrin. Agron Xhafaj duhet ta përfshinte ligjin antimafia.

ERION BRAÇE: Zoti Noka, kërcënimet në një demokraci kushtetuese janë të tepërta. Nëse doni ta merrni pushtetin me dhunë si në 26 maj 1996, merreni, këtu jemi, bujrum. E keni provuar edhe më parë dhe e keni lëshuar qetësisht.

FLAMUR NOKA: Mburoja politike e të vëllait, trafikant droge i dënuar. Do të dalë material tjetër që do të vërtetojë katërcipërisht që gjatë kohës që ministër i Brendshëm është Fatmir Xhafaj, i vëllai i tij ka qenë shumë aktiv në trafikun e drogës.

ERJON BRAÇE: Zoti Noka, nuk funksionon që ti të shpall fajtor dhe pastaj duhet ta bëjnë institucionet këtë. Jo mor zotëri jo, vetëm tek kasapi funksionon kështu. E vë delen atje dhe e merr, e ther dhe nuk gjykon kush.

FLAMUR NOKA: Po mbronni me forcën e kartonëve një person të përfshirë në trafikun e drogës. Me këtë arrogancë që u drejtoheni shqiptarëve, shumë shpejt do thyni qafën.

EDMOND SPAHO: E kemi trim, e ka zgjedhur Kavaja, thatë për Elvis Rroshin. Kështu thatë edhe për Saimir Tahirin, duhet të ishte në burg. Kështu thatë edhe për Arben Ndokën. Ju mund të qeshni, por kur Rama shkoi në Bundestag, nuk qeshi. Ia futën të dyja këmbët në një atlete. Ju kanë vënë dy kushte. Këtë thanë deputetët holandezë. Këtë tha presidenti francez, Macron. Këto iu thanë Ramës në Sofje.

un e komisionit, Erjon Braçe, prokuroria do të hetojë dhe do të zbardhë ngjarjen, pasi në demokraci nuk bëhen gjyqe familjare. "Bujrum, urdhëroni, merreni me dhunë pushtetin si në '96, kërcënimet janë të rënda në raport me ligjin. Zoti Noka nuk funksionon që ti të shpall fajtor dhe pastaj duhet ta bëjnë institucionet këtë. Jo mor zotëri jo, vetëm tek kasapi funksionon kështu. E vë delen atje dhe e merr dhe e ther dhe nuk gjykon kush", tha kreu i komisionit, Erion Braçe. Tonet e ashpër dhe përplasjet verbale nuk munguan as në Komisionin e Ligjeve, ku demokratët nuk lejuan vijimin normal të mbledhjes. "Ky komision s'do vazhdojë punë më tutje pa u shkarkuar Fatmir Xhafajn", deklaroi deputeti Oerd Bylykbashi. Por kreu i komisionit, Ulsi Manja kërkoi: "Më lini të vijoj detyrën". Kryeministrin e akuzuan se tashmë ka gati skenarin që synon mbylljen e hetimeve, pa vënë para drejtësisë vëllain e ministrit të Brendshëm për trafik droge. "Janë aq të forta provat, sa sot drejtori i përgjithshëm i policisë u takua me Donika Prelën, do hetojnë nëse Agroni është i dyshuar apo jo, mos u ktheni në koperturë të narkotrafikut dhe narkopolicisë", deklaroi deputeti Strazimir. Pas akuzave, opozita braktisi mbledhjen e komisionit, ndërsa Ulsi Manja përgjigjien ia dha duke i kujtuar 'dëshmitarin X'. Mazhoranca vijoi e vetme shqyrtimin e projektligjit për "Profesionin e Avokati" në Republikën e Shqipërisë. "Ora e gallatës mburoi, ora e 'Babales' mburoi", tha Ulsi Manja, teksa deputetët e PD dhe LSI lirin karriget e Komisionit të Ligjeve.

ÇESHTJA "XHAFAJ"

INTERVISTA

Kryeministri paralajmëron: Nëse prokuroria i shkon në fund, do të shikohet diçka tronditëse

Kryeministri Edi Rama deklaroi dje, se, nëse audio-përgjimi i publikuar për vëllain e ministrit Fatmir Xhafaj del i vërtetë, atëherë ai do të rishikojë pozicionin e tij. Por, nga ana tjetër, Rama tha se në rast se prokuroria del në përfundim se video nuk është autentike, por e montuar, atëherë ata që e kanë bërë një gjë të tillë duhet të mbajnë përgjegjësi ligjore. Gjatë një interviste për ABC News nga Gjirokastra, Rama lajmëroi se, nëse prokuroria i shkon deri në fund hetimit të audio-përgjimit, del diçka tronditëse.

Cfarë mendimi keni për punën e ministrit Xhafaj?

Unë kam një opinion pozitiv në punën e ministrit bazuar në fakte, në rezultate në përkushtimin e tij në një punë për të çuar përpara transformimin e Policisë së Shtetit. Shenjat e qarta që policia ka dhënë në goditjen e krimit të organizuar, por edhe në disa prekje interesante të fshehta të krimit me politikën e ka vënë në shënjestër ministrin Xhafaj. Çështja ndaj tij ka qenë një këmbëngulje e opozitës që procesi i negociatave me Bë-në të dështojë.

Opozita është krenjt e çoroditur dhe kapet si i mbyturij pas fijos së barit, duke krijuar situata që të marrë një kredo morale.

A keni menduar ta largoni nga detyra Xhafajin deri në sqarimin e rastit, dhe ta riktheni sërish?

Shkarkim për arsye morale? Jetojmë në një sistem ku nga moshja 18 vjeç, "secili berr varet nga këmbët e veta" dhe askush nuk mund të implikohet një vëlla se ka një vëlla. Në pozicionin e kryeministrit nuk mund të bëj vlerësime bazuar në pretendime.

Kam kërkuar me urgjencë nga një agjenci e specializuar të di të vërtetën e audio-përgjimit. Nëse do të kishte të dhëna për këtë që "një vëlla është aktiv në këtë aktivitet" e bën të pamundur që vëllai të jetë ministër. Unë nuk mund të bëj vlerësime bazuar mbi pretendime, unë i bëj mbi fakte, dhe gjykoj punën dhe rezultatet. Kur zgjedha Xhafajin si ministër, këtë fakt e kam ditur që unë, opozita dhe publiku që ka qenë i vëmendshëm ndaj lajmeve, kjo e ka filluesën që në 2002. Unë kam kërkuar një analizë specifike, që nëse provat lidhin aktivitetin e tij kriminal aktual, atëherë do të kishte një lidhje me ministrin, jo drejtpërdrejt, por përgjigja e kam marrë unë për këtë çështje është shumë e qartë. Kam marrë përgjigjen e një agjencie të specializuar ndërkombëtare. Por kjo që unë them nuk duhet marrë nga askush si një përgjigje përfundimtare. Secili ka të drejtë të ketë dyshimet e tyre. Nëse pretendimi është i vërtetë në këtë rast pozicioni im do rishikohet dhe rivlerësohet, por, nëse prokuroria nxjerr me një mbështetje shkencore, thotë që kemi të bëjmë me një falsifikim, atëherë

"Xhafaj", Rama: Nëse audio-përgjimi është i vërtetë, rishikoj pozicionin

"Kapja e 613 kg drogë, lidhje me njerëz të lartë në PD"



Kryeministri Edi Rama

jemi në kushtet e një strukture kriminale.

Unë besoj se e njoh sesi është ndërthur historia. Janë struktura që kanë vepruar në harmoni dhe në bashkëpunim për të prodhuar këtë, me qëllim.

A është pasuria e vëllait të ministrit të Brendshëm e ngritur në mënyrë të paligjshme?

Pasurinë më të madhe të paligjshme sipas zërave të opozitës, e kam unë, por kjo s'mund të jetë dot një arsye.

Ku e gjetët audio-përgjimin?

Është marrë nga shfaqja që u bë. Kam marrë të dhënat që ishin në dispozicion, dhe iu siguroj që sot bota ka laboratorë shumë të sofistikuar.

Nuk është zëri i Agron Xhafaj në përgjimit?

Kam marrë përgjigjen e një agjencie të specializuar të huaj.

Keni krahasuar zërin e Agron Xhafajit me atë të përgjimit?

Nëse prokuroria thotë që përgjimi është autentik, sigurisht që unë duhet ta rikonsideroj pozicionin tim ndaj ministrit, por nëse përgjigja e prokurorisë është se materiali nuk është autentik, atëherë ata që e kanë bërë duhet të mbajnë përgjegjësi përpara ligjit.

A jua ka paraqitur Xhafaj dorëheqjen?

Pse duhet të ma kërkojë Xhafaj dorëheqjen?

Kaq e vështirë është të gjeni njerëz të mos kenë të afërëm të implikuar në trafikë të caktuara në kabinet?

Një familje, një parti politike, një organizatë nuk mban përgjegjësi për faktin që një anëtar i familjes mund të bëjë një mëkat, mund të shkelë ligjin. Nëse do të niseshim nga akuzat, unë jo më që s'duhet të isha me

këtu, por s'duhet të isha më në faqe të dheut.

Mendoni që kanë të bëjnë edhe klanet brenda PS që mund të kenë një përballje me Z. Xhafaj dhe punën e tij?

Unë nuk e mendoj këtë për arsyen e thjeshtë se e kam pak a shumë të qartë, le të themi, 80 përqind të pikturës e kam të qartë se si është zhvilluar dhe po ju them se nëse prokuroria do t'i shkojë deri në fund, njerëzit do të shikojnë diçka që vërtetë, është shumë tronditëse. Këtu janë përfshirë struktura.

A nuk mendoni se mund të intimidoni prokurorinë?

Absolutisht jo, sepse nuk bëhet fjalë për një çështje

TAULANT BALLA

"Unë po ju them me bindje dhe informacion, emra nuk kam, po ju them që është një gjyqtar që ka shkuar edhe në Gjykatën e Kasacionit në Itali dhe ka kërkuar dosjen e të dënuarit, Agron Xhafaj në Itali. Kërkesat në Itali lënë gjurmë. Ndaj këtij procesi shantazhimi janë bërë bashkë interesa politikanësh të korruptuar dhe gjyqtarë. Fatmir Xhafaj është jo vetëm drejtues i reformës në drejtësi, por është një prej ideatorëve të vettingut në drejtësi", -tha dje, Balla.

qëndrimi apo opinioni, bëhet fjalë për diçka që është matematikisht e sigurt. Mjafton që prokuroria t'i drejtohet kujtoda agjencie ndërkombëtare që ka një laborator shkencor, që mund të nxjerrë të vërtetën dhe të marrë përgjigje. S'ka lidhje me si mund të intimidohet, është thjeshtë çështje teknike.

U kapën 613 kg drogë..

Procesi i hetimit ka hyrë në një fazë të re, me arrestimin e personit që deri tani ishte identifikuar si koka e trafikut dhe nga krahu tjetër, të dhënat që unë disponoj në rrugë operative janë të mjaftueshme se përse është ky acarim i opozitës. Ka dyshime shumë të arsyeshme që të çojnë drejt njerëzish shumë të lidhur me rangjet të larta të PD. Ka informacione që të lindin dyshimin e arsyeshëm, pastaj hetimi do prova për ta faktuar këtë ose do ta hedhë poshtë. Nuk mendoj se në Shqipëri ka mafie... sigurisht në Sh-

qipëri ka njerëz që mund të kenë lidhje, dhe në rastin e kokainës mundësia është e lartë dhe lidhen me pushtetin e dikursheëm dhe opozitën e sotme. Unë nuk jam si kundërshtarët e mi, që kanë një kulturë shpife dhe që bëjnë një akuzë të drejtpërdrejtë tek një person. Por di të them se në rastin e kokainës, ka dyshime të arsyeshme që të çojnë shumë lart te pushteti i kaluar, opozita e sotme.

Pse është gjithë ky acarim? Pse PD genka e acaruar nga kapja e 613 kg kokainë dhe ndalimi i një personi në Gjermani?

Sepse ka dyshime shumë të arsyeshme që të çojnë drejt njerëzish shumë të lidhur me rangjet me të larta të PD.

Dyshime të arsyeshme apo informacione?

Informacionet krijojnë dyshimin e arsyeshëm, pastaj është hetimi që duhet të provojë dyshimin e arsyeshëm me prova.



Gjatë një seance parlamentare

Kreu i qeverisë: Do ndërtojmë aerodrom në Gjirokastrë dhe aeroport në Vlorë e Kukës

Vendi ynë shumë shpejt do të ketë tri aeroporte. Veç aeroportit ekzistues të Rinasit në Tiranë, vendi do të ketë në funksion aeroportin e Kukësit, teksa do të ndërtohet dhe ai i Vlorës. Gjithashtu, qeveria po vlerëson dhe ndërtimin e një aerodromi në Gjirokastrë. Këtë e bëri të ditur dje, në Gjirokastrë, kryeministri Edi Rama, në përfundim të mbledhjes së qeverisë. "Ajo që mund t'ju them është se jemi në diskutim dhe s'do bëjmë normalisht dy aeroporte, por jemi duke vlerësuar mundësinë dhe krijimin e një aerodromi edhe në Gjirokastrë. Por gjithnjë pas një llogarie të mirëmenduar ekonomike, pasi shumë shpejt vendi ynë do ketë tri aeroporte, Rinasin, do futet në punë ai i Kukësit dhe do ndërtohet aeroporti i Vlorës, çka do ishte luku të kishim dhe një në Gjirokastrë", - tha Rama. Kryeministri Edi Rama gjatë një dëgjese me qytetarët ka folur për drejtësinë, administratën, por edhe probleme të tjera, ndërsa nuk ka kursyer edhe batutat. "Të pasurojmë administratën nga ata që janë mësuar të jetojnë si parazitë. Është e pavërtetë dhe manipulim i madh që ne i paskemi dhënë qindra milionë oligarkëve për koncesionet, sepse duket se kemi marrë nga arka qindra milionë dhe ua kemi dhënë atyre, e vërteta është ndryshe", -tha ai.

Hapat se si do të veprohet nga ALUIZNI në 9 qarqe të vendit

Qeveria, 2 miliardë lekë kompensim për pronarët që preken nga ndërtimet informale

Pronarët e pronave private dhe pasurive të paluajtshme, të cilat preken nga ndërtimet informale do të kompensohen financiarisht. Këshilli i Ministrave vendosi në mbledhjen e tij ditën e djeshme se vlera e kompensimit për 76.535.39 m2 do të jetë 1 083 745 912,78 (një miliard e tetëdhjetë e tre milionë e shtatëdhjetë e pesë mijë e nëntëqind e dymbëdhjetë presje shtatëdhjetë e tetë) lekë. Kompensimi financiar do të jetë për pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, për sipërfaqet takuese të zëna nga ndërtimet informale, në drejtoritë e ALUIZNI-t: Tiranë Veri, Tiranë Jug, Tiranë Shtesat, Kamzë, Vorë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Korçë, Durrës dhe Sa-

randë. Sipas vendimit të qeverisë janë ndarë edhe hapat se si do të veprohet. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, përkatësisht, në Tiranë, Kamzë Vorë, Elbasan, Vlorë, Lezhë, Korçë, Durrës dhe Sarandë, të kryejnë ndryshimet përkatëse për këto pasuri në regjistrat e pasurive të paluajtshme. Për zbatimin e vendimit ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave/Ndërtimeve Informale, Agjencia e Trajtitimit të Pronave, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.



Darina Tanushi

45-vjetori i revoltës së Spaçit, burgut më famëkeq të diktaturës u kujtua dhe në një aktivitet ku morën pjesë Presidenti i Republikës, Ilir Meta si dhe ambasadorët të vendeve të BE-së, ish-të burgosur e familjarë të tyre. Kreu i shtetit u shpreh në fjalën e tij, se kjo ditë shërbon edhe si reflektim. "Heronjtë e Spaçit sakrificuan jetën dhe vitet e tyre më të bukura në mbrojtje të dinjitetit njerëzor, të lirisë dhe të së vërtetës. Në kujtesën e kombit, ata do të jenë shembuj të vetëdijes qytetare dhe kombëtare për të ardhmen. Sot është një ditë kujtese, por edhe reflektimi, prandaj përbalja me të shkuarën dhe çlirimi i shoqërisë nga makthi i krimeve të diktaturës ngelet prioriteti serioz për të gjithë politikën dhe shoqërinë tonë. Përvoja botërore na mëson se tragjeditë e së kaluarës, nëse harrohen, janë të destinuara të rikthehen në një formë apo mënyrë tjetër", u shpreh Meta. "Këshillu - vijoi më tej - Presidenti - zbejha e kujtesës historike krijon premisa jo vetëm për tendencën e totalitarizmit, por edhe të ksenofobisë, racizmit, ekstremizmit, krimiit dhe përgjigjeve të ndaj - tha Meta - trajtimi me objektivitet dhe paanshmëri i të vërtetave historike merr një rëndësi të veçantë". "Ne jemi një komb evropian dhe historia jonë nuk mund të trajtohet jashtë perspektivës evropiane të Shqipërisë. Të mos harrojmë se vetë integrimi evropian është krijuar dhe ka në themel një aleancë kundër tmerrëve të diktaturave të kaluara fashiste e komuniste. Ky projekt vazhdon. Në këtë këndvështrim, vendi ynë duhet të vazhdojë trajtimin e së kaluarës me transparencë dhe drejtësi, për rehabilitimin, integrimin dhe dëshm-përblimin e plotë të shtresës së të përndjekurve politikë", theksoi Meta. Ai propozoi ngritjen e një përmendoreje në kujtim të disidencës, viktimave të pafajshme të diktaturës, vuajtjeve dhe përpjekjeve të tyre, duke e cilësuar këtë si një detyrim të së gjithë shoqërisë, ashtu sikurse cilësoi si obligim edhe gjetjen dhe nderimin e të gjithë eshtrave të të vrarëve e të zhdukurve gjatë kësaj periudhe. Meta tha se do mbështesë çdo nisim për ndërtimin e përmendoreve për kujtimore dhe në veçanti të Muzeut të Burgut të Spaçit. "Në përfundim dua të theksoj se revoltat demokratike në të gjithë botën në përgjithësi kanë përdorur simbolika të veçanta nga kultura dhe identiteti shpirtëror e artistik i popullit të vet. Para 45 vjetëve heronjtë e Spaçit zgjodhën simbol të aspiratës së tyre flamurit kuqez të Skënderbeut! Këtu në Spaç ra për herë të parë ylli komunist, i cili do të binte një herë e përgjith-

45-vjetori i revoltës së Spaçit, presidenti: Një ditë kujtese e reflektimi

Meta: Përmendore në kujtim të viktimave të diktaturës në Spaç

Vlahutin: Shqiptarët u persekutuan se donin të ishin në Europë

DEKLARATA
Kryetarja e Delegacionit të Bashkimit Evropian në Tiranë, ambasadorja Romana Vlahutin theksoi dje në ceremoninë e 45-vjetorit të protestës në burgun e Spaçit se, "detyra jonë si evropianë është të luftojmë dhe punojmë për një Shqipëri për të cilën jetuan, punuan dhe vdiqën të dënuarit e Spaçit".



Presidenti i Republikës, Ilir Meta



Alibeaj kërkon ndjesë publike: Nuk kemi bërë aq sa duhet për të përndjekurit

Deputeti demokrat, Enkelejd Alibeaj kërkoj ndjesë dje, në emër të PD-së që nuk i kanë trajtuar siç duhet shtresën e ish-të përndjekurve politikë. Alibeaj ka qenë dje në një aktivitet në kuadër të 45-vjetorit të revoltës së Spaçit. Në fjalën e tij, ai tha se nuk është aty si deputet i PD, por si një njeri që nga mesi i viteve '80 dëgjoi për herë të parë emrin Spaç dhe ju kthye në makth ky emër. "Nuk vij këtu si deputet i PD, por vij si një njeri që nga mesi i viteve '80 dëgjova për herë të parë emrin Spaç. Kur prindërit na tregojnë se si vinin për t'u sjellë bukë të afërmeve tanë. Ku erdha sot këtu ndjeva trishtim. Spaçi na u kthye në makth atëherë. Unë do thosha që është momenti për ndjesë, për ata që kanë pasur në dorë për të bërë diçka. Ndjesë që nuk kemi bërë aq shumë për shtresën e të përndjekurve politikë. Asfiksia i lirisë, e së ardhmes, e shpresës janë të njëjta si 45 vite më parë. Harresa është armiku më i madh i së shkuarës, por mbi të gjitha i së ardhmes. Sot është dita kur duhet të kërkojmë ndjesë", u shpreh deputeti demokrat.

Kreu i PD-së u bën thirrje shqiptarëve të bashkohen në protestë

Basha: Të mos lëmë pasardhësit e xhelatëve të Spaçit të na sundojnë

Kryetari i PD-së, Lul Kzimi Basha deklaroi dje në 45-vjetorin e revoltës së Spaçit se ka ardhur koha që shqiptarët të vendosin për të mos lejuar që pasardhësit e xhelatëve të Spaçit të sundojnë nën fasadën e demokracisë. Në një postim në rrjetin social "Facebook", Basha shkroi dje: "45 vjet pas revoltës së Spaçit, Shqipëria është në pikën më kritike të saj! Xhelatët e Spaçit dhe pasardhësit e tyre qeverisin vendin bashkë me krimin dhe po ua vrasin pak nga pak çdo ditë lirinë dhe shpresën shqiptarëve. Pasardhësit e kriminit komunist në bashkëpunim me krimin e organizuar dhunojnë lirinë e zgjedhjes, dhunojnë lirinë e pronës, vjedhin dhe shkatërojnë çdo ditë shpresën që shqiptarët të jetojnë me dinjitet në vendin e vet dhe të izolojnë Shqipërinë, duke na mbyllur derën e Perëndimit dhe duke u kthyer në pengesën e vetme për Shqipërinë si



gjithë Europa". Ai tha se, "ka ardhur koha që shqiptarët të vendosin, nëse do të lejojnë pasardhësit e xhelatëve të Spaçit të na sundojnë nën fasadën e demokracisë, apo do të ngrihem të gjithë bashkë për të çliruar vendin nga bashkëqeverisja me krimin". "Partia Demokratike është gati ta udhëheqë dhe ta fitojë këtë betejë bashkë me shqiptarët që nuk duan ta lënë të ardhmen e fëmijëve të tyre në duart e krimiit! Së bashku e udhëhoqëm dhe e fituam betejën për të larguar nga parlamenti dhe qeverisja

vrasësit, trafikantët, përdhunuesit. Së bashku, ia dolëm të ndërjegjësojmë SHBA-të dhe Bashkimin Evropian se nën drejtimin e Edi Ramës, Shqipëria u kthye në vendin kryesor të prodhimit dhe trafikut të drogës, se ministri i tij i Brendshëm, Saimir Tahiri ishte pjesë e trafikut ndërkombëtar të drogës", tha më tej Basha. Ai u ka bërë thirrje shqiptarëve të ngrihen në protestë më 26 maj për ta çliruar "shpresën dhe ëndrrën për Shqipërinë evropiane nga qeveria më antieuropiane".

OLTA XHAÇKA

Ministria e Mbrojtjes, Olta Xhaçka nisi dje vizitën zyrtare në Izrael. Xhaçka është ministria e parë e Mbrojtjes që viziton Izraelin. Ajo do të pritë në një takim zyrtar nga homologu i saj izraelit, Avigdor Liberman. Xhaçka do të takojë edhe drejtues të institucioneve të sigurisë, mbrojtjes së dhe të industrisë ushtarake në Tel Aviv e Jerusalem.



kitarës për të kënduar këngët e Adriano Çelentanos. Shqiptarët u persekutuan sepse donin të ishin poetë, mendimtarë, piktorë dhe studiues. Donin të ishin si pjesa tjetër e Europës. Është e vështirë të mendohet që tragjeditë që kanë ndodhur në Spaç apo në mbarë Shqipërinë janë tragjedi që t'i tregojmë si histori dhe t'i shërojmë", tha ajo. "Kemi përgjegjësinë të mësojmë nga e shkuara që e ardhmja të jetë me ndershmë. Të ruajmë Spaçin si një vend kujtese dhe reflektimi që fëmijët tanë t'u mësojnë fëmijëve të tyre për atë që ka ndodhur këtu", u shpreh Vlahutin.

monë nga flamuri ynë kombëtar në dhjetor të vitit 1990", tha Meta.

AMBASADORJA E BE

E pranishme, ambasadorja e BE-së në Tiranë, Romana Vlahutin kujtoi se të rin-

jë mund të dënoheshin vetëm se këndonin këngët e Adriano Çelentanos. Ajo tha se shqiptarët u persekutuan vetëm se donin që vendi i tyre të ishte si e gjithë Evropa. "Është e vështirë, thuajse e

pamundur të mendosh që në Evropën e cila ka shkuar në hënë, ka shpikur internetin, ka biometrinë, zemrën artificiale, 4 dekada më parë një djalosh i ri mund të dënohej vetëm sepse i kishte rënë

Afati i ri për taksën, Ahmetaj: Nga 1 janari 2019 zbatohet e plotë

Ornela Manjani

Shtyhet taksë e pronës, do të paguhet në vitin 2019

Kadastra fiskale mban peng zbatimin e taksës

Qytetarët do ta paguanë taksën e re të pronës duke filluar nga 1 janari i vitit të ardhshëm. Edhe pse ishte parashikuar të hynte në fuqi që nga muaji i kaluar, qeveria ka vendosur që ta shtyjë zbatimin e taksës së re me kërkesë të bashkive. "Perioda deri në janar të 2019-ës është lënë si periudhë tranzitore, që u lejon njësitë vendore që të përgatiten mirë, në mënyrë që në 1 janar 2019, të gjitha njësitë vendore të aplikojnë taksën e pronës në bazë të vlerës", deklaroi ministri i Financave, Arben Ahmetaj. Prej vitësh, taksë e pronës në Shqipëri është paguar si tarifë fikse mbi sipërfaqen. Por, me formulën e re ajo llogaritet sa 0.05% e vlerës së pronës. Sipas qeverisë, kjo formulë bën një shpërndarje më të drejtë të barrës fiskale. Në mungesë të kadastrës, që ende nuk është gati, ministri i Financave, Arben Ahmetaj e ka konsideruar 2018-ën një periudhë tranzitore për zbatimin e kësaj takse mbi vlerë tregu.

MINISTRI

"Përsa i përket taksës së pronës, jemi shumë të qartë. Metodologjia është e kristalstalt deri në detaje. Janë gati mbi 900 tabela të shpërndara zyrtarisht në të gjitha bashkitë e vendit dhe punonjësit e Ministrisë së Financave, të Departamentit të Taksës së Pronës (e kadastrës fiskale) praktikisht janë



Ministri i Financave, Arben Ahmetaj

FORMULA E RE

Prej vitësh, taksë e pronës në Shqipëri është paguar si tarifë fikse mbi sipërfaqen. Por, me formulën e re ajo llogaritet sa 0.05% e vlerës së pronës. Sipas qeverisë, kjo formulë bën një shpërndarje më të drejtë të barrës fiskale. Në mungesë të kadastrës, që ende nuk është gati, ministri i Financave, Arben Ahmetaj e ka konsideruar 2018-ën një periudhë tranzitore për zbatimin e kësaj takse mbi vlerë tregu.

duke ndihmuar njësitë vendore në të gjithë vendin. Ajo që dua të theksoj është se taksë e pronës nuk është një

taksë e re, nuk është një taksë që është rritur, përkundrazi, në shumë kategori është ulur, është bërë më

transparente, është bazuar tek vlera. Do u japim më shumë mundësi tatimpaguesve të dinë çfarë dhe për

vlerës", u shpreh Ahmetaj. Kreu i Financave ka shpjeguar se 1 janari 2019 është afati i fundit. "1 janari është limiti i fundit. Viti 2018 është përdorur si periudhë tranzitore me kërkesë të vetë qeverive vendore, për t'u përgatitur dhe për ta provuar metodologjinë në një periudhë tranzitore prej 6 deri në 9 muaj", ka thënë Ahmetaj.

TAKSË

Taksë e pronës mbi vlerën e tregut ka hyrë në fuqi nga 1 prilli. Qytetarët paguanë 0.05% për banesat e tyre, ndërsa bizneset 0.2% të vlerës së godinës ku ushtrojnë aktivitetin. Në mungesë të kadastrës fiskale, që është sistemi që përcakton vlerën e saktë të pronës sipas zonave, bashkitë po orientohen në bazë të çmimeve referencë të nxjerra nga qeveria dhe të botuara tashmë në Fletoren Zyrtare.

Taksë e pronës mbi vlerën e tregut ka hyrë në fuqi nga 1 prilli. Qytetarët paguanë 0.05% për banesat e tyre, ndërsa bizneset 0.2% të vlerës së godinës ku ushtrojnë aktivitetin. Në mungesë të kadastrës fiskale, që është sistemi që përcakton vlerën e saktë të pronës sipas zonave, bashkitë po orientohen në bazë të çmimeve referencë të nxjerra nga qeveria dhe të botuara tashmë në Fletoren Zyrtare.



Shoqata e Bimëve Mjekësore: Zhvlerësimi i euros na dëmton shteti të na kompensojë

Shoqata e Bimëve Mjekësore dhe Aromatike të Shqipërisë ka ngritur zërin lidhur me dëmin që po pëson kjo industri nga luhata e monedhës euro. Në një konferencë të hapur me anëtarësinë e saj, u diskutua me shqetësim situata e krijuar rreth sfidës që po hasin, për shkak të zhvlerësimit të euros dhe dollarit, për eksportet e bimëve, erëzave dhe esencave të vendit tonë. Konferenca u hap nga presidenti i shoqatës, Filip Gjoka, i cili ndër të tjera theksoi rëndësinë e bashkëpunimit të industrisë IBMA, me qëllim krijimin e një zëri të vetëm dhe të fortë në mbështetje të kësaj industrie. Presidenti Gjoka gjatë fjalimit të tij deklaroi: "Sektori i bimëve mjekësore dhe aromatike ka një impakt të rëndësishëm në ekonominë shqiptare me rreth 45 milionë dollarë eksporte në vit dhe 90.000 individë të si grumbullues, fermerë, përpunues, eksportues të punësuar kryesisht në zonat rurale, duke ndikuar ndjeshëm në uljen e papunësisë në këto vende. Në jemi sektori i vetëm në vendin tonë që realizojmë eksporte direkte si produktet e bimëve mjekësore dhe aromatike në tregun e huaj evropian dhe atë amerikan". Më tej, kreu i shoqatës tha se, zhvlerësimi i monedhës së huaj si ajo e euros dhe dollarit ka shqetësuar muajt e fundit kompanitë eksportuese. Ata vlerësojnë se ka një rrezik të madh nëse nuk do të ketë ndërhyrje me politika stimuluese në këta sektorë jetikë të ekonomisë së zhvillimit, kryesisht të zonave rurale të vendit tonë. "Monedha evropiane euro krahasuar me lekun ka arritur pikën më të ultë të këmbimit që nga viti 2008. Rënia e euros në kuotën e 126.8 lekëve nga 139-140 që ishte para 5-6 vitësh ka dhënë e vazhdon të japë ndikime mjaft negative për bilancet e sipërmarrjeve që punën e të ardhurat e tyre i kanë të mbështetura në eksportet e produkteve të krijuara. Kuptohet se mbicimi i euros ka ardhur nga një stabilitet i rritjes ekonomike, nga rritja e investimeve të huaja, nga remitancat që vijnë nga emigrantët, të hyrat nga vizitorët e turistët etj.", - tha më tej Gjoka. Kompanitë e grumbullimit, përpunimit dhe eksportimit të bimëve mjekësore e estero-vajore me kursin aktual kanë një humbje vjetore, që llogariten në disa milionë lekë. Kjo situatë e krijuar do të sjellë shkurtime dhe vende të punës si dhe uljen e investimeve në përpunimin e standardizimin e produkteve, sipas tyre. Në konferencë u theksua se nëse do të vazhdohej me këto ritme, këto kompani janë të detyruara të ulin pagat, të heqin dorë nga disa aktivitete për të mos falimentuar përfundimisht.

Rrugët dytësore, nija Milot

ARRSH tender 10 milionë euro, ja ndërhyrjet që parashikohen



Milot-Fushë Krujë me gjatësi 752 m, aksi Fushë Krujë-Lezhë me gjatësi 1463 m. Po kështu, është parashikuar vendosja e sinjalistikës horizontale për vijëzimin e rrugës, realizimin e zebriave e simboleve të ndry-


shme sipas vizatimeve përkatëse si dhe vendosja e reflektorëve të asfaltit sycionale realizohet nëpërmjet rrugëve dytësore, duke shfrytëzuar nënkallimin ekzistues Gurëz-Milot në njërin anë, si dhe mbikallimin ekzistues të Patokut në anën tjetër të njëjës re së Milotit. Janë gjithsej 7 rrugë dytësore dhe 13 rrugë të brendshme të përfshira në projekt, me gjatësi totale 11 910 m. Punimet në këtë projekt pritet që të zgjasin 15 muaj nga nënshkrimi i kontratës.

Shitje me Ankand të dyte nga Studio Permbartore L.D.C

Pershkrimi i pasurive:
 1. "Trulli - Ndertesë", me Nr. Pasurie 84/5/1 ndodhur ne ZK 1247, Vol. 9 fage 143 me adrese ne Borizane, Kruje. Regjistruar ne Zyren Vendore Regjistrimit Pasurive Palaujstme Kruje. Regjistruar ne omer te Ramadan Selim SHMA.
 Pasuria 84/5/1 e Iljiti Trulli me sipërfaqe 250 m2, 2 kato banese si dhe një kati / papafingo shtese.
 Cmimi lilestar pas shije eshte percakuar te jete 12.800.000 Loke (dymbedjete milion e teoqind mijë) loka.
 Data e shpalljes: 10.05.2018
 Data e zhvillimit: 31.05.2018 deri ne oren 16.00
 Ankandi zhvillohet ne ambientet e zyres Studio Permbartore L.D.C te ndodhur ne adresen: Rruga "Mystym Shyrt", Vila 8/1, Kati 1, Tirane, e-mail letter.casaj@yahoo.com.

Autoriteti Rrugor Shqiptar ka hapur një tjetër procedurë prokurimi lidhur me rrugët dytësore në njërin Milot. Referuar dokumenteve të këtij institucioni, bëhet me dije se fondi limit i vënë në dispozicion është rreth 10 milionë euro i ndarë në tri vite. Në objekt të kontratës parashikohen dy komponentë, së pari përfundimi i punimeve për vënie në shfrytëzim të njëjës së Milotit dhe së dyti, kryerja e volveve të punës sipas projekt-preventiv të zbatimit të rrugëve dytësore, punime që janë të lidhura domosdoshmërisht me vënie në shfrytëzim të njëjës së Milotit. ARRSH ka ndarë në specifikimet e saj teknike edhe punimet që do të kryhen për secilin nga komponentët. Kështu, ndërtimi i njëjës lidhëse e rrugës Milot-Lezhë-Rrëshen-Thumanë është pjesë e rrjetit rrugor kombëtar dhe i përket njëkohësisht si korridorit veri-jug, ashtu dhe aksit Durrës-Kukës-Morinë. Projekt-preventivi i kontratës parashikon ndërtime të një interchangë në kryqëzimin e autostradës Milot-Rrëshen-Kukës-Morinë dhe asaj Fushë Krujë-Milot-Lezhë. Njya përbëhet nga dy akse dhe katër rampa: aksi

DURRES - Prokuroria e Durrësit ka shpallur ditën e djeshme moskompetencë për hetimet ndaj prokurorëve Dritan Gina dhe Rovena Gashi, të marrë si të pandehur për akuzën e refuzimit për deklarim dhe fshehjes e deklarimit të rremë të pasurisë. Mësohet se çështja i ka kaluar për hetim organit të akuzës në Fier, pasi bashkëshortët Gina dhe Gashi pretendojnë se hetimi



Prokuroria e Durrësit shpall moskompetencë për prokurorët Gashi-Gina

mi po bëhet për hakmarrje personale. Më herët, ata janë shprehur se Anita Jella, kryeprokurore e Durrësit është shoqe e kryeprokurorës Arta Marku. Burime jozyrtare pranë Prokurorisë së Durrësit thonë se shkak për ta dërguar çështjen në Fier përveç afërsisë,

është edhe fakti se ky institucion nuk ka konflikt me aktivitetin që kanë ushtruar më herët bashkëshortët. Kujtojmë se më 14 maj, Prokurorja e Përgjithshme e përkohshme, Arta Marku i pezulloi nga detyra Ginën

dhe Gashin deri në përfundim të hetimeve dhe gjykim-it të çështjes. Bashkëshortët Gashi-Gina kanë një histori të gjatë përbaljeje me kryeprokurorën Marku. Në javën e parë të marrjes së detyrës, shefja e re e organit qendror të akuzës shkarkoi

nga detyra e drejtoreshën e Marrëdhënieve me Jash-të, Rovena Gashin. Ndërsa rreth 2 javë më pas i ndërpreu komandimin si prokuror i Prokurorisë së Elbasanit bashkëshortit të saj, Dritan Gina. Këto lëvizje nuk u pritën mirë nga detyshja Gashi-Gina, të cilët e kallëzuan kryeprokurorën, njëri në Gjykatën Administrative, ndërsa tjetri pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

I shpallur në kërkim ndërkombëtar, e shkuara kriminale e 37-vjeçarit Bledar Jambelli

Vrasja e komisarit Cuku, mbyllen hetimet për ekzekutorin Mikel Shallari

Kërkohet statusi i bashkëpunëtorit, zbuloi emrin e porositësit

Prokuroria e Krimeve të Rënda ka përfunduar hetimet për Mikel Shallarin, i cili akuzohet se ekzekutoi ish-drejtorin e Policisë së Vlorës, Artan Cukun, në 8 prill të 2017-ës. Organi i akuzës i ka kërkuar gjykatës që Shallari t'i shpëtojë dënimit të përjetshëm dhe të ligjërohet si bashkëpunëtor i drejtësisë. Kjo, pasi 24-vjeçari ka pranuar vrasjen dhe ka treguar emrin e personit që e ka porositur. Sipas Shallarit, porositësi i vrasjes është Bledar Jambelli, një emër jo i panjohur për policinë. Kjo kërkesë për Mikel Shallarin do të shqyrtohet nga gjyqtarja Miliana Muça.

POROSITËSI
Emri i porositësit të vrasjes së ish-komisarit Artan Cuku u zbulua rreth një vit pas ekzekutimit të tij. Personi i cili kontraktoi Mikel Shallarin për ekzekutimin e Cukut, dyshohet të jetë 37-vjeçari Bledar Jambelli. Ai është shpallur në kërkim ndërkombëtar me vendim të Gjykatës për Krime të Rënda, e cila ka caktuar për të masën e arrestit me burg. Nga hetimet disamujore dhe provat e grumbulluara, grupi i hetimit ka dalë në konkluzionin se ish-drejtori i Policisë së Vlorës u vra për shkak të detyrës në radhë të uniformave blu. Nga hetimet rezultoi se në dhjetor të 2012-ës, Artan Cuku e vuri në pranga fterakun Jambelli, pas dyshimeve se ishte autor i vrasjes së Armando Delajt në shtator të po të njëjtit vit. 38-vjeçari Jambelli rezultoi një emër i njohur për policinë. Ai figuron në herët si i përfshirë në veprimtari kriminale. Ndaj tij u caktua edhe masa e arrestit me burg për vrasjen e Shpëtim Mukës, Ervin Shehut dhe plagosjen e Ervis Zanajt në nëntor të 2006-ës. Ngjarja në fjalë dyshohet se kishte lidhje me një vrasje të ndodhur në Spanjë, që u pasua më pas me një zinxhir krimesh të rënda, që tronditën Vlorën e Tiranën. Pavarësisht, dyshimeve që rëndonin mbi të, Bledar Jambelli ia doli mbanës të rifitonet lirinë, por masa duket konflikt i hapur me kryekomisararin vazhdonte. Sipas




Mikel Shallari në sallën e gjyqit

hetuesve, ai kontraktoi të dyshuarin Mikel Shallari për ekzekutimin e ish-drejtorin e Policisë së Vlorës. Hetuesit thonë se Shallarit i dha fillimisht shumën prej

3 mijë eurosh, ndërsa pjesën tjetër të pagesës do t'ia bënte kur të kishte kryer vrasjen, të cilën e realizoi prillin e vitit të kaluar në derën e pallatit ku banonte kryeko-

KËRKESA
Organi i akuzës i ka kërkuar gjykatës që Shallari t'i shpëtojë dënimit të përjetshëm dhe të ligjërohet si bashkëpunëtor i drejtësisë, pasi 24-vjeçari e ka pranuar vrasjen dhe ka treguar emrin e personit që e ka porositur. Sipas Shallarit, porositësi i vrasjes është Bledar Jambelli, një emër jo i panjohur për policinë.

misari, në Krugën e Kosovarëve në kryeqytet. Hetimet për çështjen në fjalë janë drejt finalizimit dhe pritet që në fund të majit dosja t'i dorëzohet gjykatës.



Kokaina në Durrës, Ardi Veliu takim me partnerët te Krimet e Rënda, analizohet dosja

Kreu i Policisë së Shtetit, Ardi Veliu, zhvilloi para ditën e djeshme një takim në Prokurorinë e Krimeve të Rënda. Mësohet se të pranishëm në takim kanë qenë edhe partnerët ndërkombëtarë. Burime nga organi i akuzës bëjnë me dije se takimet u zhvilluan në kuadër të hetimeve për sasinë prej 613 kg kokainë që u kapën në Portin e Durrësit më 28 shkurt. Për shkak të zhvillimeve intensive për këtë dosje, Ardi Veliu zhvilloi takime pune në prokurori për të bashkërenduar hetimet mes Policisë së Shtetit dhe Prokurorisë së Krimeve të Rënda, në bashkëpunim edhe me partnerë ndërkombëtarë. Ndërkohë, mësohet se në këtë takim nuk ka qenë e pranishme drejtuesja e Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Donika Prela. Kujtojmë se më 4 maj u bë i mundur arrestimi i Arbër Çekaj në Gjermani, pronari i kompanisë së bananeve që kishte bërë porositjen nga Kolumbia. Ai ishte shpallur në kërkim ndërkombëtar dhe pritet që të ekstradohet në Shqipëri. Kapja dhe sekuestrimi i sasisë rekord prej 613 kg 350 gr lëndë narkotike e dyshuar kokainë, me vlerë tregu mbi 180 milionë euro u bë e mundur si rezultat i operacionit policor të koduar "Last Snow". Hetimet dokumentuan se lënda narkotike ishte nisur me konteiner nga Kolumbia duke kaluar transit përmes Italisë, në Maltë e më pas me anije ka mbërritur në Portin e Durrësit në Shqipëri, më 19 shkurt të këtij viti. Sipas policisë, kokaina ishte e fshehur në konteiner me dysheme të dyfishtë, të ngarkuar me banane. Sakaq, të arrestuar për këtë trafik ndërkombëtar droge janë edhe Armand Pezaku dhe Donald Lushaj, të cilët priten ngarkesën në port.

Policia e Rinasit nxjerr të dhënat, 19 arrestime për një javë

TIRANË - Policia Kufitare e Rinasit ka intensifikuar punën për parandalimin dhe goditjen e paligjshmërisë, duke ndaluar një sërë personash të akuzuar për vepra të ndryshme penale, gjatë javës që kaloi. Në kuadër të forcimit të masave të sigurisë dhe parandalimit e ngjarjeve të rënda kriminale, për sezonin turistik në aeroportin e Rinasit, në ndihmë të Policisë Kufitare është duke kryer shërbim edhe FNSH-ja. Gjatë javës që kaloi nga shërbimet e Policisë Kufitare Rinas janë evidencuar 20 vepra penale në fushën e "Falsifikimit të pasaportave apo letërn-

joftimeve, "Kalimit të paligjshëm të kufirit" si dhe "Prishje e rendit dhe qetësisë publike". Janë kapur gjithsej 19 persona në kërkim për llogari të drejtorive dhe komisarivate vendore. Në kuadër të bashkëpunimit me vendet e BE-së për parandalimin e azilkërkimit, gjatë javës që lamë pas janë përpunuar në kategorinë "deportiv", 324 shtetas të kthyer nga vendet e BE-së, të cilëve iu është refuzuar kërkesa për azil politik, apo janë kapur pa dokumente qëndrimi. Janë refuzuar në dalje nga Republika e Shqipërisë 62 shtetas, pasi nuk plotësonin kushtet për të udhëtuar drejt vendeve të

Bashkimit Europian. Gjithashtu, iu është refuzuar hyrja 10 shtetasve të huaj, që dyshohet se udhëtonin me dokumente të falsifikuara. Janë procedurë penalisht për kalim të paligjshëm të kufirit 11 shtetas, të cilët kanë kaluar kufirin jeshil në mënyrë të paligjshme nga pika të ndryshme të kalimit kufitar dhe janë kthyer "deportiv" nga policitë homologe. Policia Kufitare e Rinasit ka marrë një sërë masash për përmirësimin e cilësisë së shërbimit, duke eliminuar në maksimum vonesat qoftë në përpunimin e dokumentacionit, ashtu edhe të kontrollit fizik dhe të bagazheve.

SHPLLJE

(PËR SHITJEN E SENDIT TË PALUAJTSHËM NË ANKAND)

ME DATE 04.06.2018 NGA ORA 8:00 - 16:00, PRANE KESAJ ZYRE PERBARIMORE DOTE ZHVILLOHET ANKANDI I rrethë-III PER SHITJEN E APARTAMENTIT ME SUPERFACE 80.25 m2 NR. PASURIE 46/2020ND+1-36, ZK 8518, V0413 VENDOSUR NE DURRES L. 13 PLAZHINE PROMESI TE SHOQERISE SIAC SH.P.K. - CMIMI PER SHITJEN NE ANKANDIN E III ESHTE 2.150.000 LEKE.

Te interesurit te paraqiten prane zyres perbarimore A.D.R, Perbarues Gjyqesor Dorian Zazani, ne adresen : Durres, l.nr 2, r. A. Goga, ose te kontaktojne ne nr. tel: 0672586883

Operacioni në "Ujin e Ftohtë", AKU ndëshkon me 200 mijë lekë gjobë Ediator Qibinin

Brika Meta

GJIROKASTER

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit në Gjirokastrë, në bashkëpunim me policinë e këtij qarku kanë kryer një operacion për goditjen e aktivitetit të paligjshëm të tregimit të produktit "Mjalt" nga tregtarë ambulantë në zonën e "Ujit të Ftohtë" në Tepelenë.

Gjatë këtij operacioni u konstatua se tregtari ambulant Ediator Qibini po tregonte 58 kavanoza, 1 kg dhe 13 bidonë plastikë 2 kg, me produkt të pretenduar "mjaltë". Mësohet se mjalti ishte i pakontrolluar, pa certifikatë origjinë, pa raport analiza dhe pa etiketa. Produkti tregtohej në ambiente të hapura, në kushte të papërshtatshme higjienike, të ekspozuara ndaj rrezeve të diellit, ndotjeve dhe kushteve atmosferike. Sipas analizave laboratorike, produkti, i cili pretendohet mjaltë natyral, në fakt ishte mjaltë industrial dhe jashtë parametrevë të konsumit njerëzor. Sipas informacionit paraprak, tregtarët e blinin mjaltin industrial me çmim të ulët nga prodhues të rregullt në qytetin e Korçës dhe më pas ia hiqnin etiketat që tregonin

Sekuestrohet mjaltë në Tepelenë, tregtari ambulant mashtronte turistët

Produkti ishte industrial, pa certifikatë sigurie



Mjalti i sekuestruar në Tepelenë

originën dhe përmbajtjen reale të produktit, për t'ua shitur për "mjaltë natyral" dhe me çmim të lartë, pushuesve dhe turistëve që kalonin në "Ujë të Ftohtë". Ndërkaq, AKU ndërmori ndaj shtetasit Ediator Qibini masën administrative gjobë në vlerën 200 000 lekë

dhe masën e konfiskimit të produktit "mjaltë". Ndërsa, Sektori i Krimit Ekonomik vijon hetimet për konsumin e figurës së veprave penale: të "Prodhimit dhe shitjes së ushqimeve dhe e lëndëve të tjera të rrezikshme për shëndetin" dhe të "Fshehjes të të ardhurave".

AKU i sekuestron tregtarit 10 tonë mish në Elbasan, dyshohet të jetë i kontaminuar

Pak ditë më parë, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit sekuestroi rreth 10 tonë mish në Elbasan, i cili dyshohet se është i kontaminuar. Sasia e madhe e mishit u sekuestrua në lagjen "5 Maji" të këtij qyteti, në subjektin e 42-vjeçarit Elibert Latifi. "Nga kontrolli i ushtruar nga policia në bashkëpunim me AKU-në, në lagjen "5 Maji", në subjektin fizik të këtij shtetasi, i cili tregton e përpunon produkte mishi, ka rezultuar se ky subjekt tregtonte e përpunonte produkte mishi i papajisur me licencë nga K.K.L, si dhe pa etiketë produkti. Në këtë subjekt u bllokuan nga specialistët e AKU-së, 978 kg mish derri, 3840 kg kofshë pule, 3920 kg fileto pule, 37 kg mish viçi, 111 kg qofte dhe 645 kg gjiro gici, produkt i gatshëm për analiza të mëtejshme, pasi dyshohen si të kontaminuara", thuhet në njoftimin zyrtar të policisë. Sipas bluve, Latifi akuzohet për "Prodhim i kundraligjshëm i artikujve dhe mallrave industriale dhe ushqimorë". Gjithashtu, mësohet se sasia e madhe e mishit ka qenë e blerë nga një subjekt i licencuar.



Kapet 26-vjeçari italian me gomone në ujërat shqiptare, dyshohet se do trafikonte drogë

SARANDË - Një gomone e dyshimtë është bllokuar dhe nga Policia Kufitare e Sarandës në ujërat pranë vendit të quajtur "Gjiri i Kasolles". Policia e ka pikasur gomonen teksa ia afrohej bregut dhe e ka ndaluar atë. Brenda në mjet është gjetur vetëm drejtuesi, italiani Antonio Summa, 26 vjeç, banues në Brindisi, Itali. Ndërkohë, burime burimeve konfidenciale nga policia e Sarandës pohuan se 26-vjeçari italian ka hyrë ilegalisht në ujërat shqiptare. Për rrjedhojë, ai është shpërndarë në komisariatet e Sarandës, ku po merret në pyetje, pasi dyshohet se mund të ketë ardhur për të marrë ndonjë sasi droge në brigjet shqiptare. Po sipas bluve, brenda në mjetin lundrues është gjetur edhe një telefon celular, që është sekuestruar si pjesë e procesit hetimor: arsu.

Shënohen lëkundje të tjera tërmeti në Vlorë, banorët: E kemi gdhirë jashtë nga frika

VLORE - Lëkundjet e tërmetit kanë shkakuar panik në qarkun e Vorës, pas 14 tërmeteve që goditën në fundjavë. Si pasojë e tërmeteve që nisën që të premtën që shkoi, në disa fshatra të këtij rrethi janë dëmtuar 20 banesa, ndërsa pesë prej tyre janë bërë të pabanuara. Lëkundjet e tokës kanë vijuar një ditë pasi një tërmet me magnitudë 4.6 ballë goditi këtë qark. Pas tërmetit me intensitet të lartë të së shtunës, janë ndërë lëkundje edhe gjatë natës të së dielës, por me intensitet më të ulët. Instituti i Gjeoshkencave njofton se tërmeti i ka qenë me magnitudë 3 ballë. Epiqendra ka qenë 3 km nga fshati Vermik dhe me një distancë 16 km nga Tepelena. Banorët, edhe mbrëmjen e së dielës kanë qenë të shqetësuar dhe kanë fjetur me frikë. Disa prej tyre kanë fjetur jashtë nga frika se do përfundon poshtë gërmadhave të shtëpive të tyre. Problemet më të mëdha janë shënuar në fshatrat Bashaj, Matogji dhe Vermik. Ndërkaq, prefekti i Vlorës, Flamur Mamaj, ka deklaruar se do të largohen nga shtëpitë familjet që rrezikojnë. "Kemi



Banorët që e gdhinë jashtë nga frika e tërmetit

disa ditë që gjendemi në terror. Lëkundjet e tërmetit nuk kanë të ndalur. Dëmtat materiale janë të shumta, por më kryesorja është se kemi frikë se do përfundojmë poshtë rrënojave. Kërkojmë ndihmë nga shteti. Prej dekadash nuk kemi përjetuar një situatë të tillë", thanë disa banorë të fshatit Bashaj në rrethin e Vlorës. "Që para tri-katër ditësh ka pasur lëkundje. Ranë gurë dhe për pasojë u dëmtua rruga, u ndalua qarkullimi. Janë dëmtuar edhe banesa, frikën e kemi se është fuqi e madhe natyrore. Jam 60 vjeç dhe nuk mbaj mend një situatë të tillë", tha një tjetër banor. Nga ana tjetër, prefekti Mamaj tha se deri tani dy banesa janë të pabanueshme

si pasojë e dëmtimeve që kanë pësuar nga tërmeti, ndërsa sot do të mblidhet Shtabi i Emergjencave. "Nga verifikimet e mia, në fshatin Bashaj janë dy banesa të pabanueshme. Janë edhe të vjetra. Ndërsa banesat e tjera janë të riparueshme. Kam folur me kryetarin e Bashkisë së Selenicës dhe deputetin dhe nesër (sot) në orën 12:00 do të mblidhet Shtabi i Emergjencave. Duke pasur parasysh që tërmeti i parë ka ndodhur në datë 14, i fundit sot (dje), kam porositur që të bëjnë kujdes në zonat e rrezikshme, duke qëndruar jashtë banesave që rrezikohen nga shembëmbjntë", u shpreh prefekti.



OPEN CALL FOR TENDER

PREQUALIFICATION

1. GENERAL CONDITIONS

- 1.1. Requester:** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit GmbH (GIZ), Office Tirana, Rr. Skenderbej, No. 21/1.
- 1.2. Profile:** German Development Cooperation, Office in Tirana supports Albania on its path to European integration and development through projects implemented in: Economic development, Economic legal reform, Vocational education and training, Reform of the water sector, Rural development, and some other areas.
- 1.3. Subject:** The GIZ Office Tirana invites qualified design companies to "Provide Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality.

2. Companies should fulfill the following requirements:

- 2.1 The Companies have to be licensed as an engineering designer.
- 2.2 The Companies have to be experienced in the designing of the common design works.
- 2.3 The Companies have to fulfill the complete design and cost estimated for the future civil works of construction.

All legal entities interested in application process should ask for an application form to the address: giz-albanien@giz.de

- 3. The due date** for submitting the application is **25 May 2018**. The documents should be submitted in a sealed envelope, marked "Application for prequalification of Design Stabilisation (Composting) Plant at Vumblo Transfer Station, Himara Municipality", addressed to:

German Development Cooperation Office (GIZ), Office in Tirana, Rr. Skenderbeg, No. 21/1 Tirane

After the due date for submitting the application, the process of prequalification will follow. The submitted applications will be evaluated, and only prequalified candidates will be invited to answer to the bid.

Reagon Mitropolia e Fierit: Nuk ka ardhur asnjë ankesë ndaj klerikut

"Një klerik pedofil në Fier, nëna e të miturit shkoi te kryepeshkopi Janullatos"

Gazetari Alfons Zeneli, thirrje ortodoksëve shqiptarë: Abandononi kishat e Janullatosit!

FIER

Mitropoliti i Fierit, Hirësia Nikolla (Arjan Pelivan Hyka) ka dorëzuar klerik një ish-katekist të shpunësuar dhe të dëbuar nga kisha për abuzime seksuale në kampin e fëmijëve të KOASH-it, mbas denoncimit që bëri vetë familja e të miturit". Kështu ka shkruar ndër të tjera në një status në "Facebook", gazetari Alfons Zeneli. Ndërsa, thekson se nëna e djalit të abuzuar e kishte denoncuar ngjarjen tek kryepeshkopi Anastas Janullatos, por sipas tij, ky i fundit nuk kish të bërë asgjë. "Iu bëj thirrje ortodoksëve shqiptarë që t'i abandonojnë kishat e Janullatosit. T'i abandonojnë djajtë e veshur me veladon. Më mirë djepi bosh, se shejtani brenda. Vetëm kështu mund të shpëtohet nderi i ortodoksëve shqiptarë, e cila është avangardë, namndritur e atdhedashurisë, dijës dhe besimit të vërtetë në Zot", shkruan gazetari. Pas denoncimit të publikuar në rrjetet sociale, ka reaguar Mitropolia e Shënjtë e Apollonisë dhe Fierit, e cila i ka hedhur poshtë akuzat, duke thënë se të gjitha pretendimet janë shpifje. Sipas Hirësi Nikolla, në Mitropolinë e Fierit nuk është bërë asnjë ankesë, qoftë nga kleri, qoftë nga besimtarët.

STATUSI I AFLONS ZENELIT

KLERIK PEDOFIL NË FIER

Mitropoliti i Fierit, Hirësi Nikolla (Arjan Pelivan Hyka) ka dorëzuar klerik një ish-katekist të shpunësuar dhe të dëbuar nga Kisha për abuzime seksuale në kampin e fëmijëve të KOASH-it, mbas denoncimit që bëri vetë familja e të miturit. Edhe pse fillimisht katekisti ishte pushuar nga puna, ai po rekrutohej sërish. Nëna e viktimës shkoi tek kryepeshkopi Anastas dhe i tregoi shenjat e abuzimit seksual në trupin e fëmijës së saj, Fortlurturia e Tij e pa të arsyeshme që mos ia prishte lumturive priftit të vet pervers dhe e dha bekimin që pedofili të hyjë në radhën e klerit të KOASH-it. Fortlurturia e tij (dhe e atyre), kryepeshkopi i Durrësit, Tiranës dhe i gjithë Shqipërisë, hirësia e tij Anastas




Gazetari Alfons Zeneli

pasi shpërfill, përdhos, fshi nga mendja e besimtarëve shqiptarë At Nolin, At Visarion Xhuvani, At Stath Melanin dhe Papa Kristo Negovanin e plot të tjerë të masakruar nga paraardhësit e vet të Kishës greke po injektin në korpusin e ortodoksëve sonë 'tarbiatet seksuale' të kishës së tyre. Kisha greke, në raport me Shqipërinë dhe ortodoksinë shqiptare, ka qenë thjesht një organizatë kriminale dhe terroriste. Ka shumë priftërinj të lartë në hierarkinë e Kishës greke që janë ngjirur deri në fund të jetës duke mallkuar publikisht shqipërit dhe shqiptarët e duke bekuar pushtët dhe thikat e paraushtarakëve që masakruan popullsinë civile në Korçë, Kolonjë e Përmet. Tani që nuk ushtrorjnë dot dhunë fizike, kanë nisur sulm të një lloji tjetër si ky rasti që përmendim pak më lart, duke i lënë besimtarët në dorën e "meshave" të priftërinjve perversë, homoseksuale e pedofilë. Iu bëj thirrje ortodoksëve shqiptarë që t'i abandonojnë kishat e Janullatosit. T'i abandonojnë djajtë e veshur me veladon. Më mirë djepi bosh, se shejtani brenda. Vetëm kështu mund të shpëtohet nderi i ortodoksëve shqiptarë, e cila është avangardë namndritur e atdhedashurisë, dijës dhe besimit të vërtetë në Zot.



REAGIMI I MITROPOLISË

Në reagimin e zyrës së Mitropolisë së Shënjtë të Apollonisë dhe Fierit thuhet: "Deri tani nuk u jemi përgjigjur shpifjeve dhe akuzave tuaja ndaj Klerikut të Mitropolisë sonë, por duke dashur që të qartësojmë besimtarët tanë edhe opinionin publik, po tregojmë të vërtetën mbi dorëzimin e klerikut në fjalë. Dorëzimi i tij në klerik është bërë sipas gjithë rregullave dhe kanoneve të Kishës Ortodokse. Së pari, kemi dëshminë e Atit të tij shpirtëror, i cili nuk ka gjetur asnjë pengesë për dorëzimin e tij si klerik. Së dyti, në Mitropolinë tonë nuk ka ardhur asnjë ankesë, qoftë nga kleri, qoftë nga besimtarët, që të ngrejë akuzë ndaj këtij kleriku apo të kundërshtojë dorëzimin e tij në shërbesën e priftërisë.



Ambasadori amerikan Donald Lu shpallet "Qytetar Nderi"

LIBRAZHËD - Ambasadori amerikan në Tiranë, Donald Lu, është nderuar dje me titullin "Qytetar Nderi" i Librazhdit. Këshilli i Bashkisë së këtij qyteti me unanimitet të plotë të të gjitha partive politike ia dha zyrtarisht amerikan këtë titull. Motivacioni ishte: "Një mik i veçantë, i cili erdhi e u këmbëkryq në odat e krahinës mikpritëse të Librazhdit. Mirënjohje që foli troç dhe shqip, mirënjohje për rolin e rëndësishëm në ndërtimin e drejtësisë së re në Shqipëri, je gjithmonë i mirë-pritur në Librazhd, zoti ambasador Lu". Kohë më parë ambasadori Donald Lu takoi familjen e myftiut Ylli Gurra në Dragostunjë.

NJOFTIMI I TELEKOM ALBANIA SHA.

Lajmërim zyrtar lidhur me përditësimin e paketave mujore: Paketa S, M, L, XL dhe Electronic Beats. Duke filluar nga data 28 Qershor 2018 Telekom Albania do të përditësojë paketat standarde. Më poshtë njësitë që do të përbëjnë këto paketa duke filluar nga data 28 Qershor 2018.

	Paketa S	Paketa M	Electronic Beats	Paketa L	Paketa XL
Minuta kombëtare	200	2500	400	3000	3500
Minuta drejt rrjeteve fikse	100	200		300	500
Minuta drejt rrjeteve ndërkombëtare				10	60
SMS drejt TELEKOM		2000	400	2500	3000
SMS drejt rrjeteve të tjera kombëtare	400			400	500
SMS drejt rrjeteve ndërkombëtare		300			
Volumet Interneti (MB/GB)	200MB	2GB	5GB + Social Media & Chat (10 GB)	5 GB	10 GB
Vlefshmëria	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë	30 ditë
Çmimi (me TVSH)	800 Lekë	1200 Lekë	1400 Lekë	1400 Lekë	2000 Lekë

Klientët me parapagesë, të cilët do të kenë në përdorim një nga paketat standarde në momentin e ndryshimit, do ta përdorin atë të pandryshuar deri në përfundimin e vlefshmërisë së kësaj pakete. Për më shumë informacion vizitoni dyqanet Telekom ose Shërbimin e Klientit në 142.

Duke ju falenderuar paraprakisht,
Telekom Albania sha



CASTE QË NA LIDHIN.

Studentet e Elbasanit po shkonin për ekspeditë në Himarë

Tragjedia e 6 viteve më parë, si humbën jetën 13 persona në aksidentin tragjik në Qafën e Vishës

HIMARË - Dje u mbushën plot 6 vite nga aksidenti tragjik në Qafën e Vishës në Himarë, ku 13 jetë u prenë në mes. Aksidenti tragjik ndodhi më 21 maj të vitit 2012 në afërsi të Himarës, teksa autobusi me studente të universitetit "Aleksandër Xhuvani" të Elbasanit humbi kontrollin dhe ra në humerë. Ish-te ora rreth 16:15, kur autobusi lëvizte në drejtim të Sarandës në kuadrin e një ekskursioni-ekspeditë, një udhëtim që u prë në mes. Ndonëse kanë kaluar disa vite, dhimbja e familjarëve të viktimave mbetet e njëjtë, ndërsa vuajnë mungesën e vajzave të tyre. Në këtë ak-



Aksidenti tragjik në Himarë

sidenti të tmerrshëm humbën jetën 11 studente të vitit të tretë, dega Gjuhë-Letërsi, i fejuari i njëres prej të reja, si dhe drejtuesi i autobusit, ndërsa u plagosën 22 vajza të tjera studente. Si asnjë ngjarje më parë, ajo tragjedi do të mbahet mend

për solidaritetin e treguar nga banorët e Himarës, të cilët u bënë një, duke ndërrhyrë të parët në operacionet e shpëtimit. Destinacioni fillestar ishte qendra shëndetësore e Himarës, vetëm pak minuta larg vendngjarjes. Një ditë më pas, më 22 maj i gjithë vendi do të ishte në ditë zie kombëtare, në respekt të jetëve të prera në mes. Homazhet do të kulmonin në Universitetin e Elbasanit, vendi ku vajzat ndiqnin çdo ditë leksionet në auditorin. Pavarësisht se kanë kaluar vite, humbja e jetëve të 11 studenteve ka lënë pas brenjë për familjarët, të afërmit, por edhe për pedagogët e këtij universiteti.

KOLEGJI UNIVERSITAR "LUARASI" OFERTAT PËR STUDENTËT

Rektori: Një numër i konsiderueshëm maturantësh janë pararegjistruar në këtë institucion elitare

"Luarasi", Fakultet të ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit

Ethem Ruka: Programe studimi që i nevojiten tregut

Voltiza Duro

Kolegji Universitar "Luarasi" do të çelë Fakultetin e ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit për të gjithë studentët që do të fillojnë studimet në vitin akademik 2018-2019. Hapja e tri departamenteve të reja i jep këtij institucioni arsimor elitare statusin e universitetit, duke qenë i vetmi që ofron këtë fakultet në vend. Në një intervistë për "Gazeta Shqiptare", rektori i "Luarasit", prof. dr. Ethem Ruka tregon se qëllimi i universitetit është të ofrojë programe studimi për të cilat ekonomia ka nevojë. Më tej, Ruka shton se nga takimet për këshillimin e karrierës me rreth 20 mijë maturantë është shpjeguar rëndësia që kanë teknologjitë e informacionit dhe interesi i treguar nga të rinjtë ka qenë përtej pritshmërive. Prej disa kohësh stafi akademik i "Luarasit" po zhvillon takime me maturantët në mbarë Shqipërinë mbi këshillimin e karrierës, ku po shpjegohen në mënyrë të detajuar programet, kurrikulat që ofrohen për studentët nga ky institucion. Gjithashtu, rektori bën me dije se kanë pritur edhe shumë maturantë nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi e madje shton se një numër i konsiderueshëm maturantësh janë pararegjistruar për të ndjekur studimet pranë këtij institucioni elitare e veçanërisht për teknologjitë e informacionit.

Ministria e Arsimit disa ditë më parë ka miratuar hapjen e Fakultetit të ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit në Kolegjin Universitar "Luarasi". Cilat janë departamentet e reja që do të ofrohen për studentët?

Kolegji Universitar "Luarasi" vjen me një ofertë tjetër të re për maturantët, që fillojnë studimet në vitin e ardhshëm akademik 2018-2019, atë të studimeve për teknologjinë e informacionit dhe inovacionit. Më datën 14.05.2018, Ministria e Ar-



Rektori i "Luarasit", prof. dr. Ethem Ruka



Stafi i "Luarasit", gjatë takimeve me maturantët për këshillimin e karrierës

simit, Sporteve dhe Rinisë me Vendimin Nr.266 aprovoi hapjen e një Fakulteti të ri për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit, ku përfshihen tri departamente: Departamenti i Teknologjisë së Informacionit e Inovacionit, Departamenti i Informatikës

Ekonomike dhe Departamenti i Matematikës e Statistikës.

Pse lindi nevoja për hapjen e këtij fakulteti?

Sot askush nuk mund të vejë në diskutim rolin e pazëvendësueshëm që luajnë teknologjitë e informacionit në jetën ekonomike,

SYNIMI

"Qëllimi ynë është të ofrojmë programe studimi për të cilat ekonomia ka nevojë. Nga takimet për këshillimin e karrierës me rreth 20 mijë maturantë kemi shpjeguar rëndësinë që kanë teknologjitë e informacionit dhe kemi konstatuar se interesi ka qenë përtej pritshmërive tona", - thotë Ruka.

sociale dhe politike. Termat shoqëri informacioni, revolucion informatik, "fshati global", revolucioni i dijës, revolucioni në fushën e komunikimit etj., kanë fituar qytetari në fjalorin e zakonshëm ditës. Këto teknologji kanë ndikuar dhe po



rreth 20 mijë maturantë kemi shpjeguar rëndësinë që kanë teknologjitë e informacionit dhe kemi konstatuar se interesi ka qenë përtej pritshmërive tona. Specialistët e kësaj fushe kanë më shumë shanse për të gjetur një vend pune, për të punuar online për kompani të huaja si dhe për të hapur biznese vetjake.

Prej disa kohësh ju po organizoni takime me maturantë në të gjithë Shqipërinë mbi këshillimin e karrierës. Çfarë kanë në fokus këto takime dhe a kanë treguar interes të rin-

studimeve (Bachelor) në Teknologjitë e informacionit e inovacionit, është parashikuar një Masteri profesional për Sigurinë Kibernetike dhe Informacionin si dhe Masteri shkencor për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit. Këto programe kanë për qëllim të sigurojnë një lidhje organike mes teknologjisë së informacionit dhe biznesit. Në mbarim të këtij cikli të diplomuarit do të kenë mundësi jo vetëm të identifikojnë nevojat e biznesit, por të propozojnë edhe zgjidhje mbështetur në këto teknologji të kohës. Po ashtu, studentët do të kenë mundësi të marrin njohuri të thelluara mbi sigurinë e informacionit dhe mbrojtjen nga abuzimet që mund t'i atakojnë ato.

Si do të realizohet procesi mësimor për 3 departamentet e Fakultetit të ri të Teknologjisë së Informacionit dhe Inovacionit?

Kolegji Universitar "Luarasi" me hapjen e fakultetit të tretë fiton statusin e universitetit. Ai është i pari universitet që hap një fakultet të tillë. Ne kemi përgatitur të gjithë infrastrukturën e nevojshme për funksionimin normal të procesit mësimor dhe kemi nënshkruar kontratat e punës me një staf akademik të përkushtuar në teknologjitë e informacionit.

Përse maturantët duhet të zgjedhin Kolegjin Universitar "Luarasi"?

"Luarasi" përfaqëson një institucion të Lartë Arsimor Jpublik nga më të mirët në vend. I akredituar për gjashtë vite akademike, ky institucion garanton cilësi të lartë në mësimdhënie. Është konkurrues në çmim e mbi të gjitha lëshon diploma që janë shumë të vlerësuara në tregun e punës.

PROGRAMET E REJA MASTER

"Përveç ciklit të parë të studimeve (Bachelor) në Teknologjitë e Informacionit e Inovacionit, është parashikuar një Masteri profesional për Sigurinë Kibernetike dhe Informacionin si dhe Masteri shkencor për Teknologjinë e Informacionit dhe Inovacionit", - shprehet rektori.

ndikojnë fuqimisht në globalizmin e kulturës dhe komunikimit, pjesëmarrjen në politikë, kujdesin shëndetësor, shërbimet publike, aktivitetet kulturore, veprimtarinë qeverisëse, biznesin, edukimin në distancë, sistemin bankar, aeronautikën, avacionin, mbrojtjen, shërbimet inteligjente, kërkimin shkencor, rrjetet sociale, postën elektronike, tregtinë online, telefoninë celulare, teknologjitë audiovizive etj., etj.

Pra, është vetë tregu që u jep rëndësi këtyre fushave të studimit?

Qëllimi ynë është të ofrojmë programe studimi për të cilat ekonomia ka nevojë. Nga takimet për këshillimin e karrierës me

jtë?

Jo vetëm që kemi vizituar thajse të gjitha shkollat e mesme të Shqipërisë nga Saranda e deri në Shishtavec të Kukësit, por edhe shumë shkolla kanë organizuar vizita për t'u njohur më nga afër me Kolegjin Universitar "Luarasi". Jemi të nderuar që kemi pritur maturantë edhe nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i Zi. Për ne është kënaqësi që një numër i konsiderueshëm maturantësh janë pararegjistruar për të ndjekur studimet pranë këtij institucioni elitare e veçanërisht për teknologjitë e informacionit.

A do të ofrohen programe të reja studimi nga "Luarasi"?

Përveç ciklit të parë të



Rektori i "Luarasi", prof. dr. Ethem Ruka gjatë takimit me maturanët

Administratori: Projekti, transformim i raportit student-pedagog-universitet

Risia në "Luarasi", korrigjim automatik i provimeve

Elvin Meka: Rritim transparencën për studentët

Voltiza Duro

Një tjetër risi për Kolegjin Universitar "Luarasi" është edhe zbatimi për herë të parë i projektit "CleanScore", i njohur ndryshe edhe si korrigjimi automatik i provimeve. Njëpërmjet kësaj risie, synohet që të rritet transparencja në vlerësimin e studentëve, si dhe të përmirësohet cilësia e mësimdhënies duke zëvendësuar librat aktualë me versione cilësore të njohura ndërkomëtare. Aktualisht ky projekt dhe standard ka filluar të studimit Master shkencor "Financë-Bankë" te "Luarasi".



Standarti i ri "CleanScore"

jet e kapitaleve", që zhvillohet në programin e studimit Master shkencor "Financë-Bankë" te "Luarasi". Administratori i këtij universiteti, prof.asoc.dr. Elvin Meka tregon për "Gazeta Shqiptare" se zbatimi i projektit "CleanScore" synon vendosjen e një standardi të lartë cilësie dhe transparence, në drejtim të kontrol-

lit të dijeve të studentëve. "CleanScore" është një projekt i mbështetur nga Fondi Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, (AADF), për korrigjimin automatik (të kompjuterizuar) të provimeve, që synon rritjen e transparencës në vlerësimin e studentëve, si dhe përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies, duke zëvendësuar librat aktualë me versione cilësore të njohura ndërkomëtare. Ky projekt kërkon të transformojë tërësisht raportin student-pedagog-universitet në favor të cilësisë, duke minimizuar dhe luftuar fenomenin e notës fiktive dhe të pamerituar", - tregon Meka.

LËNDËT

Aktualisht ky projekt dhe standard ka filluar të zbatohet në lëndën "Institucionet financiare dhe tregjet e kapitaleve", që zhvillohet në programin e studimit Master shkencor "Financë-Bankë" te "Luarasi".

Pyjet në Dibër, një resurs i neglizhuar nga qeveria dhe pushteti lokal, dje dhe sot!

Pyjet njihen për rëndësinë dhe ndikimin që kanë të komunitetet rurale dhe urbane. Edhe në Bashkinë e Dibërës, pyjet kanë rëndësi, si për prodhimin e qëndrueshëm të biomasës drusore, ashtu dhe për sigurimin e një game të gjerë produktesh e shërbimesh.

Vlerësimi i përgjithshëm për pyjet është se kanë kontribut të rëndësishëm për sigurimin e druve të zjarrit për familjet, pasi vlerësohet se 99% e burimit të energjisë për ngrohje vjen nga pyjet. E po ashtu, nga pyjet vjen edhe lëndë për fushën e ndërtimit. Shoqata "Runja" në Dibër, me mbështetjen e "LëvizAlbania, përmes projektit "Advokimi dhe lobimi pranë Bashkisë Dibër për hartimin e një plan-vëprimi afatmesëm dhe afatgjatë për ruajtjen dhe menaxhimin pyjeve të ulta e të larta", ka konstatuar se pyjet në Dibër janë në prag të humnerës. Problematikat e këtij sektori janë parë në disa aspekte: ligjore, procedurale, administrative dhe për pasojat e rënda që krijohen në terren.

Më konkretisht: Në Bashkinë e Dibërës, që nga krijimi i saj si njësi administrative (me reformën e re territoriale) nuk ka asnjë strategji, asnjë plan menaxhimi e mbarështrimi, asnjë plan pune a dokument për sektorin e pyjeve, si për pyjet e ulëta, dhe ato të larta.

Strukturat përgjegjëse për këtë sektor kanë numër minimal punonjësish, shpesh me funksione të deleguara dhe pa përcaktim të qartë të detyrave konkrete, pa plane pune, me kërkesë illogjike në terma të përgjithshëm. Burimet njerëzore, të angazhuara nga Bashkia e Dibërës që nga momenti i transferimit e deri tani, lënë për të dëshiruar. Janë 6 punonjës të ngarkuar me sektorin e pyjeve; 2 inxhinierë të fushës, 2 me arsim të lartë dhe 2 të tjerët me arsim të mesëm. Do të ishte e gabuar të mendonim se politikebërësit dhe drejtuesit vendorë kanë vëmendje, qoftë edhe minimale, për zhvillimin e këtij sektori. E thënë më thjeshtë, Bashkia e ka vetë në dorë të krijë një strukturë të plotë, me specialiste, të paktën për të na treguar se e di dhe e vlerëson rëndësinë e pyjeve.

Materialet e punuara për periudhën gusht-2015 deri në shtator 2017 janë shumë të pakta dhe ato të punuara nga dy inxhinierët e fushës. Punimet e tyre lidhen kryesisht me vlerësimin e përgjithshëm të situatës dhe punë të ndryshme operative.

Nga ana ligjore ka patur një paketë të plotë ligjore, e cila nëse do të zbatohet, sot do të kishte një zhvillim të qëndrueshëm të pyjeve.

Ka patur edhe një moratorium për pyjet, por asnjë strukturë dhe asnjë përgjegjës nuk e zbatoi atë. Efektet e tij në Dibër janë zero. Ose nga krijimi i bashkisë së madhe nuk është dhënë asnjë leje shfrytëzimi për lëndë drusore tek asnjë nga ekonomitë pyjore, por shfrytëzimi nga disa biznese po bëhet në emër të lejeve të lëshuara vite më parë. E në fakt, zonat ku ishin marrë lejet kanë qenë dhe janë thuasje shkretëtirë. Ky fakt tregon shfrytëzimin e vjeshëm barbar, në mënyrë masive dhe të pakontrulluar.

Nga dy palët, ata që s'kanë pretenduar ndonjëherë për leje, por dhe nga ata që kanë patur një leje të viteve të shkurara.

Bizneset e kësaj fushe janë totalisht të paorganizuar dhe e zhvillojnë aktivitetin e tyre në paligjshmëri të plotë. Ashtu siç janë të paorganizuar edhe shërbimet e mbrojtjes nga zjarri në pyje. Këto shërbime nuk kanë asnjë plan për raste emergjencash.

Lista e taksave dhe tarifave për sektorin e pyjeve dhe kullotave është e përcaktuar me VKM, por nuk ka asnjë përpunim dhe rregullim të këtyre vendimit në Këshillin Bashkiak për të qartësuar agjentinë e mbledhjes së këtyre taksave e tarifave, dhe për ti bërë ato pjesë të administratës bashkake. Operohet vetëm me disa tarifa shërbimesh dhe nuk merren në konsideratë këto taksa e tarifa të përcaktuara.

Para transferimit ishte detyrë e Drejtorisë së Shërbimit Pyjor për ti mbledhur, ndërsa tani administrata nuk i mbledh dhe taksat dhe tarifat sipas VKM.

Nga intervistat dhe pyetësorët del qartë se pyjet janë sektori me kontribut më të madh në prodhimin e përgjithshëm në Bashkinë Dibër.

Puna e kryer në vitet e më hershme, me planet e mbarështrimit dhe të inventarit ka qenë e planifikuar mirë për kohën. Ka patur ndarje dhe plani-

fikim të saktë të ekonomive pyjore, edhe pse shfrytëzimi vazhonte dhe vazhdon pa kriter dhe kufi ekonomik pyjore. Dhe cila është pasoja? Është për të ardhur keq kur sheh hektarë të shkretëtuar, makina të ngarkuara me filiza të rinj, rrugë të hapura në mal për "asgjësimin" e çdo pëllëmbë pyll. Nisja e prerjeve në ngastar e vetërigjeneruara për 12-13 vite të fundit, e drurëve të pamaturuar, është një këmbanë alarmi për zhdukjen e farave dhe specieve të drurëve autohtonë pyjorë. Masat nga Bashkia dhe inspektoriatet qendrore janë zero. Këtë e vërteton fakti se të gjithë qytetarët, të cilët u përgjigjën pyetësorit tonë në funksion të projektit, pohuan se druri është burimi kryesor i energjisë dhe se ata (qytetarët) i furnizojnë biznese ose shoferë të paleicencuar, që nuk u japin asnjë dokument. Në anën tjetër, lejet për shfrytëzim janë zero.



Nga puna me projektin, shoqata "Runja", së bashku me të gjithë aktorët pjesëmarrës, ka advokuar dhe po advokon pranë Bashkisë Dibër për marrjen në konsideratë të disa rekomandimeve.

Në mbështetje të Strategjisë së re të BE-së për pyjet dhe sektorin pyjor, mendojmë se duhet të merren parasysh 6 kriteret pan-evropiane për zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve:

- a) mirëmbajtja dhe përmirësimi i duhur i burimeve pyjore dhe kontributi i tyre në ciklet globale të karbonit;
- b) mirëmbajtja e vitalitetit dhe shëndetit të ekosistemeve pyjore;
- c) mirëmbajtja dhe nxjerrja e funksioneve prodhuese të pyjeve (drusore dhe jo-drusore);
- d) mirëmbajtja, konservimi dhe përmirësimi i përshtatshëm i diversitetit biologjik në ekosistemet pyjore;
- e) mirëmbajtja, ruajtja dhe përmirësimi i përshtatshëm i funksioneve mbrojtëse në menaxhimin e pyjeve (sidomos tokës dhe uji);
- f) mirëmbajtja e kushteve dhe funksioneve të tjera social-ekonomike.

Hartimi i planeve të mbarështrimit

Mbarështrimi përfaqëson planifikimin afatgjatë, i cili përfshin grumbullimin e informacionit mbi gjendjen e pyjeve dhe kullotave dhe përcaktimin e objektivave e masave të nevojshme për trajtimin e tyre, në funksion të gjendjes dhe statusit të dhënë, me synim përmirësimin e funksioneve ekologjike, ekonomike dhe sociale, duke zbatuar dhe harmonizuar parimet e zhvillimit të qëndrueshëm, me nevojat e administruesve, pronarëve privatë dhe përdoruesve të tyre në zonat rurale.

-Bashkia duhet të përcaktojë politika të qarta, me hapa konkretë ligjorë për decentralizimin e pronësisë mbi pyjet, duke e çuar drejt fermerit.

-Bashkia, në bashkëpunim me Drejtorinë e Zonave të Mbrojtura duhet të hartojë një platform bashkëpunimi e ndërveprimi për të patur sinerji mes tyre, për një zhvillim harmonik e të qëndrueshëm të pyjeve, por edhe për përdorim ekonomik dhe efikas për popullatën.

-Bashkia e Dibërës duhet të krijojë një protokoll bashkëpunimi me qytetarët dhe QSHC-në për një mjedis të shëndetshëm nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm të pyjeve.

-Bashkia duhet të vendosë në shinat e ligjit përdorimin e tarifave dhe taksave, në përputhje të drejtë me kontributin që jep çdo sektor.

-Bashkia duhet të ndërhyjë menjëherë me rritjen e buxhetit për këtë sektor, dhe të përcaktojë një rritje progresive, në një afat të shkurtër. Objektivi është 1 pemë e prerë, 3 të mbijella.

-Bashkia duhet që vitin e parë të ketë jo më pak se 21 punonjës për këtë fushë, çka do të rrishte efikasitetin e punës së këtij sektori dhe do të ndikonte dukshëm në mbarëvajtjen e tij.

-Bashkia duhet të investojë në mjetet për minimizimin e efekteve shkatërruese të fatkeqësive natyrore, ku padysim hyjnë edhe zjarret në pyje. Një investim i tillë do të justifikonte çdo nisëm buxhetor të kësaj natyre, duke patur parasysh kostot jashtëzakonisht të larta që duhen për rehabilitimin e pasojave nga këto fenomene.

-Bashkia duhet të ndërmarrë hapa konkretë në stimulimin e qytetarëve për përdorim të burimeve alternative për ngrohje, përmes taksave vendore.

-Bashkia duhet të ndërmarrë hapa konkretë për zgjidhjen e vend-depozitimit të druve të zjarrit, në bashkëpunim me bizneset përkatëse, duke krijuar tre pika grumbullimi për qendër urbane të Peshkopisë.

Bashkia ka jo pak vështirësi, por domosdoshmëria për përmirësimin e sektorit të pyjeve, këmbëngulja e shoqatës "Runja" për marrjen në konsideratë të rekomandimeve, po bëjnë që Bashkia të ndërprejë për hartimin e planit të mbarështrimit dhe vendosjen e këtij sektori në listën e prioritetëve të saj për ndërhyrje.

Dizenjimi, zbatimi në mënyrë korrekte, kombinimi i praktikave më të mira të rritjes së pemëve me sistemet bujqësore, duke synuar zhvillim dhe përdorim të qëndrueshëm e të shumfishtë të tokës, përfshirë dhe produktet e një game shërbimesh, janë tanimë sfida të Bashkisë. Pyjet shërbëjnë për rritjen e prodhimit tek fermerët përmes produkteve të ndryshme, në periudha të formëzimit, ferma e doli në terrenë paisazhesh. Në nivel paracelle, fermerët mund të kombinonjë përmi fiksesues të oksigjenit me kulturat e drithrave. Në nivel ferme, ata mund të mbijellin pemë në toka pyjore ose përgjatë kufijve. Në shkallë paisazhi, komunitetet mund të rehabilitojnë zonat e degraduara përmes pemëve dhe llojeve të tjera të vegetacionit. Është thelbësor të kuptohet se pronësia i përket e gjitha Bashkisë Dibër, ndaj të drejtat e detyrimit janë të saj, për ndërmarrjen e hapave të qartë për zhvillim të qëndrueshëm. Shoqata "Runja", në bashkëpunim edhe me shoqëritë civile do të jenë vazhdimisht në mbështetje të aktiviteteve dhe nisimave të Bashkisë në mbrojtje të pyjeve, dhe mjedistit në përgjithësi.

Shoqata Runja, Dibër.

**PRONAT
KOMPENSIMI**

Botohet në Fletoren Zyrtare regjistri i vendimeve për vitet 1993-1997

ATP: Lista e re me 300 pronarët që marrin paratë

Përfituesve u është njohur e drejta për kompensim

Ornela Manjani

Agjencia e Trajtimit të Pronave ka përfunduar vlerësimet financiare edhe për 300 dosje pronarësh. Lista është botuar dhe në Fletoren Zyrtare dhe përmban të dhënat e plota mbi çdo dosje. Agjencia bën të ditur se në përfundim të procesit të verifikimit të vendimeve të administruara pranë arkivës së ATP-së, ka njohur të drejtën e kompensimit të subjekteve të shpronësuara për dosjet e viteve 1993-1997. Të dhënat lidhur me numrin e vendimit, gjeneralitetet e subjekteve të shpronësuara, sipërfaqja e njohur për kompensim, vlerësimi financiar përkatës apo mangësitë në dokumentacion dhe problematikën në vlerësim jepen të detajuara për çdo dosje.

APLIKIMI PËR KOMPENSIM

Pronarët që janë dakord me vlerësimin e ATP-së kanë gjashtë muaj kohë për të plotësuar dokumentet. Përfituesit duhet të dorëzojnë në ATP nëntë doku-



DOSJET

Të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjenci' për të dorëzuar kërkesën për kompensim, konfirmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim), dëshminë e trashëgimisë, prokurë, deklaratë notoriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e logarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pagese.

mente për të marrë 20% të vlerës së pronës në para dhe 80% kompensim fizik. Shifrat janë bërë të ditura nga burime zyrtare pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave,

sipas të cilave mësohet se të gjithë pronarët, për dosjet e të cilëve është dhënë një vlerësim duhet të paraqiten në 'Agjenci' për të dorëzuar kërkesën për kompensim, kon-

firmimin nga ZVRPP përkatëse mbi gjendjen juridike të pronës që kompensohet dhe nëse është ushtruar apo jo e drejta e parablerjes (nëse është njohur në vendim), dësh-

minë e trashëgimisë, prokurë, deklaratë notoriale të nënshkruar nga subjekti i shpronësuar, vërtetim për numrin e logarisë bankare, dokument identifikimi dhe mandat pag-

ese. Ndërkohë, pronarët që nuk janë dakord me vlerësim duhet që brenda 30 ditëve nga data e publikimit të listës të ankimojnë vendimin në Gjykatën Administrative të Apelit.

Data/dosje	Qarku	Emri (subjekti kërkuar)	Atësia	Mbiemri (subjekti kërkuar)	Dok. ligjor për përcaktimin e z. kadastrale të origjinës	Vlerësimi
34227	Tiranë	Anela		Dovana	Referuar regjistri	1,208,220
01.11.1993	Korçë	Sherif	Hysen	Mancellari	Truall referuar hartes se vitit	29,553,147
11.02.1994	Elbasan	MYNEVERE, BIHANE	HYSEN	ZAIMI	Referuar hartes se vendimit	1,523,940
16.11.1993	LEZHE	TRASHEGIMTARET		TIRANA	Take bujgesore referuar	-40,381,400
34129	DURRES	HALIT		XHAFI	VERETIM KADASTRAL	-213,711,312
30.08.1993	Korçë	Shefi		Buzali	vertelim hipolekor vitit 1956	1,651,250
34335	GJROKAS TER				Referuar dokumentacionit	1,154,465
30.08.1993	Shkoder	Sander		Lufi	Truall referuar hartes se vitit	7,370,526
07.01.1994	Elbasan	Shaban		Tafa	Truall referuar hartes se vitit	10,466,480
1994	KUKES	JAH		GJOCAJ	Take bujgesore referuar	-1,121,080
16/03/1994	ELBASAN	FLAMUR		GEDAJ	VERETIM PRONESIE	6,892,560
43092	Fier	Rrap		Sola	vertelim hipolekor nr 372 dt.	
19.01.1994	FIER	VEZIRE, FATMIRA,		SULAJ,		
08.11.1993	KORÇE	ERIETA	SOTIR	SHERKO	Take bujgesore sipas	700,000
34200	Durres				Prona vertelohet nga	-49,187,124
viti 1994	Elbasan	Durim		Subashi	Referuar hartes se vendimit	-2,992,828
31.08.1994	KORÇE	ILMI		HAXHI		159,400
31.08.1994	KORÇE	RAPO		HAXHI		159,400
20.10.1994	Elbasan	Bashkim		Balliu	Vendim i vlerësuar	9,976,291
34424	VLORE				REFERUAR VERETIMIT	874,344
33970	TIRANE	FIQIRI		LLAGAMI	REFERUAR VERETIMIT	109,092,501
27.07.1994	Fier	Petro	Hazbi	Paja	percakluar 500 m2 truall	165,700
01-01-1995	Vlore	Jorgo Anagrosli			Vertelim pronesi date	
20-10-1993	Tiranë	REFIK TOPTANI			Vertelim Pronesieleshuar	7,808,585
23-07-1993	Durres				Vertelim kadastral dt.	
29-08-1994	Korçë	Abaz Bazeli			Vertelim pronesie Nr.16108	0
01-01-1901	Tiranë	Ismail Kallushi			Referuar Hartes se Instituit	-170,411,640
01-01-1994	Vlore	Lame Zzoga			Referuar Vertelimit te Faktit	6,868,890
24-03-1994	Korçë	Llambi Naouçe			Vertelim pronesi date	
31-12-2014	Tiranë	Fabardha Sula			Referuar Hartes se Cytetit	-11,302,480
21-03-1994	Tiranë	ENVER DUKA			take bujgesore referuar	-141,131,228
21-03-1994	Korçë	Mihallaq Mano			Zeri kadastral i orijines	2,350,000
15-03-1994	Durres	Durres			hartes e vitit	38,819,175
08-03-1995	Durres	Kuzma Dimo			vendim shkak nr. 85 dt.	-2,611,455
09-03-1994	Tiranë	Osman Keticli			take bujgesore referuar	-7,892,828

Data/dosje	Qarku	Emri (subjekti kërkuar)	Atësia	Mbiemri (subjekti kërkuar)	Dok. ligjor për përcaktimin e z. kadastrale të origjinës	Vlerësimi
07-08-1994	Durres	Mustafa e Adem Rama			Referuar vertelimit kadastral	1,140,360
01-01-1994	Lezhë	Luigj Wuka, Zef vuka			Referuar hartes IGJF te vitit	-3,487,225
01-01-1994	Lezhë	Luigj Wuka, Zef vuka			Referuar hartes IGJF te vitit	-3,487,225
18-08-1993	Tiranë	JANULLA OIRJACI			Vertelim pronesie nga	5,913,363
01-01-1901	Fier	Hysen Musaj			Zeri Kadastral eshte	5,162,547
20-01-1994	Tiranë	QANI DISHNICA			Vertelim pronesie nga	1,339,380
06-08-1993	Tiranë	DOROTEJA ZOTO			Referuar vertelimit te	7,922,433
01-07-1994	Kukes	Mehmet Ismail Laçi			Take bujgesore referuar	
30-08-1994	Shkoder	Mark Kole Ujka				631,800
23-07-1993	Shkoder					
03-11-1993	Tiranë	REXHEP SEDI			Vertelim hipolekor nr. 431.	3,977,487
26-01-1994	Korçë	Vasil Kijollari			Vendim gjykate Nr. 691	-9,985,169
20-06-1994	Shkoder	Hamid Karakaci			Vertelimi pronesie nje	57,081,410
14-12-2017	Fier	Blerita Xhomo			Referuar Hartes se Cytetit	35,006,980
01-10-1995	Elbasan	ARTUR MOKRA			Referuar dokumentacionit	-7,866,150
01-01-1901	Durres	Besnik Domi			Vertelim kadastralleshuar	-3,037,825
25-11-1993	Shkoder	Mosi Mozall			Vertelim pronesieleshuar	1,021,320
29-08-1994	Korçë	Ylli Lico			Vertelim pronesie dt.	9,175,568
14-11-1994	Fier	Ruzhdi Borici			Vertelim nga Arkivi	6,267,800
28-03-1994	Korçë	Krisio Bello			vertelim pronesie dt.	310,074
18-03-1994	Lezhë	Kadri Ceka			Sipas hartes me vitin me te	7,591,812
07-12-2017	Fier	Vasil Toska			Referuar Hartes se Instituit	
03-08-1994	Vlore	Dudi Birçe			REFERUAR HARTES SE	-7,260,650
05-08-2008	Berat	Demir Lila			vendim nr.88 dt.29.06.1985	
01-01-1995	Fier	Mili Balashi			Referuar vendimit nr.1234	
30-08-1994	Korçë	Pandi Buluçi			Referuar vendimit pronsis	-28,895,335
01-01-1993	Gjokastër	Bashkim Bejleri			Referuar dokumentacionit	1,867,560
01-01-1901	Lezhë				Referuar vendimit 128 date	-15,112,114
24-03-1994	Korçë	Gezim Isaku			Referuar Hartes se Instituit	
19-08-1994	Shkoder	Skender Zaganjori			Vertelim Pronesieleshuar	-114,060
01-01-1994	Vlore	Leifer Oerama			Vendim gjykate nr.477	476,100
04-01-1996	Elbasan	ASIL MITRUSHI			vertelim pronesie nr. 50 dt.	199,800
27-07-1994	Lezhë	Leopold Shkrelli			Referuar dokumentacionit	1,123,584
11-03-1994	Shkoder	Allons Muzhani			Nuk percaktohet dot ne	12,968,603

30-08-1996	Korçë		Referuar vertetim pronesis	1,322,544
16-03-1994	Durrës	Spiro Prifti	Referuar vertetim pronesis	-142,727,980
09-06-1995	Shkodër	Lulzim Ulsaj	ne baze te Vertetimit te	804,800
10-11-1995	Shkodër	Zef Gjek Lulati	Seksioni i Kadasres se	484,640
01-01-1994	Shkodër	Gjergj Pjetër Duka	Vertetim kadastral viti 1947	1,418,300
713	21.11.2003		Ne shqyrtim	242	05.04.2006	Vlore	Ne shqyrtim	386	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
714	27.11.2003		Ne shqyrtim	246	05.04.2006		Ne shqyrtim	388	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
202	05.12.2003	Vlore	Ne shqyrtim	248	06.04.2006	Vlore	Ne shqyrtim	389	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
204	10.12.2003	Vlore	Ne shqyrtim	249	06.04.2006	vlore	Ne shqyrtim	393	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
44	18.12.2003	Delvine	Ne shqyrtim	251	10.04.2006		Ne shqyrtim	396	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
205	26.12.2003	Vlore	Ne shqyrtim	261	10.04.2006		Ne shqyrtim	397	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
207	06.01.2004	Vlore	Ne shqyrtim	256	10.04.2006		Ne shqyrtim	398	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
418	03.02.2004	Vlore	Ne shqyrtim	262	25.04.2006		Ne shqyrtim	399	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
208	29.02.2004	Vlore	Ne shqyrtim	265	02.05.2006		Ne shqyrtim	400	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
1552	29.02.2004	Vlore	Ne shqyrtim	267	02.05.2006		Ne shqyrtim	401	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
209	04.03.2004	Vlore	Ne shqyrtim	268	02.05.2006		Ne shqyrtim	402	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
210	19.03.2004	Vlore	Ne shqyrtim	269	02.05.2006		Ne shqyrtim	407	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
211	19.03.2004	Vlore	Ne shqyrtim	270	02.05.2006		Ne shqyrtim	408	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
212	19.03.2004	Vlore	Ne shqyrtim	271	02.05.2006		Ne shqyrtim	378	05.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
786	06.04.2004		Ne shqyrtim	272	02.05.2006		Ne shqyrtim	395	05.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
63	20.04.2004	Vlore	Ne shqyrtim	281	03.05.2006		Ne shqyrtim	425	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
66	21.04.2004		Ne shqyrtim	282	03.05.2006		Ne shqyrtim	412	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
64	29.04.2004	Vlore	Ne shqyrtim	273	03.05.2006		Ne shqyrtim	427	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
213	10.05.2004	Vlore	Ne shqyrtim	275	03.05.2006		Ne shqyrtim	409	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
65	13.05.2004	Vlore	Ne shqyrtim	277	03.05.2006		Ne shqyrtim	411	26.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
214	26.05.2004	Vlore	Ne shqyrtim	279	03.05.2006		Ne shqyrtim	413	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
215	01.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	283	04.05.2006		Ne shqyrtim	414	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
159/1	10.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	286	04.05.2006		Ne shqyrtim	415	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
1718	22.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	289	04.05.2006		Ne shqyrtim	416	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
216	24.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	290	04.05.2006		Ne shqyrtim	420	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
217	28.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	294	04.05.2006		Ne shqyrtim	421	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
716	28.06.2004		Ne shqyrtim	295	04.05.2006		Ne shqyrtim	422	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
218	29.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	300	04.05.2006		Ne shqyrtim	424	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
219	30.06.2004	Vlore	Ne shqyrtim	288	04.05.2006		Ne shqyrtim	426	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
568	05.07.2004	Vlore	Ne shqyrtim	291	04.05.2006		Ne shqyrtim	428	26.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
768	05.07.2004		Ne shqyrtim	296	04.05.2006		Ne shqyrtim	429	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
67	16.07.2004	Sarande	Ne shqyrtim	303	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	430	28.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
68	04.08.2004	Vlore	Ne shqyrtim	304	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	431	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
221	30.08.2004	Vlore	Ne shqyrtim	305	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	434	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
717	30.08.2004		Ne shqyrtim	308	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	435	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
222	03.09.2004	Vlore	Ne shqyrtim	311	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	436	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
14	06.09.2005		Ne shqyrtim	312	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	437	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
23	05.10.2005	Sarande	Ne shqyrtim	316	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	438	28.07.2006	Vlore	Ne shqyrtim
35	14.10.2005		Ne shqyrtim	317	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	441	28.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
36	17.10.2005		Ne shqyrtim	318	01.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	439	28.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
53	02.11.2005	Vlore	Ne shqyrtim	313	01.06.2006		Ne shqyrtim	440	28.07.2006	Sarande	Ne shqyrtim
70	14.11.2005	Vlore	Ne shqyrtim	302	01.06.2006		Ne shqyrtim	257	06.11.2006	Vlore	Ne shqyrtim
72	16.11.2005		Ne shqyrtim	319	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	6	05.12.2006	Vlore	Ne shqyrtim
95	08.12.2005	Sarande	Ne shqyrtim	320	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	4	05.12.2006	Vlore	Ne shqyrtim
120	15.12.2005	Vlore	Ne shqyrtim	322	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	5	05.12.2006		Ne shqyrtim
141	22.12.2005	Novosele	Ne shqyrtim	323	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	9	18.12.2006		Ne shqyrtim
131	22.12.2005	Delvine	Ne shqyrtim	325	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	16	18.12.2006		Ne shqyrtim
132	22.12.2005		Ne shqyrtim	326	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	17	19.12.2006	Vlore	Ne shqyrtim
125	22.12.2005		Ne shqyrtim	327	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	21	20.12.2006		Ne shqyrtim
138	22.12.2005	Vlore	Ne shqyrtim	329	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim	22	22.12.2006	Vlore	Ne shqyrtim
126	22.12.2005	Vlore	Ne shqyrtim	330	02.06.2006	Vlore	Ne shqyrtim			(vlon)	

TAKIMI


Anri Sala:

EKSPOZITA si organizëm i gjallë

Dekanati i FAB ka organizuar të hënën një takim të Anri Salës me studentët. Gjatë bisedës ai ju është përgjigjur pyetjeve të të rinjve për veprat e tij ndër vite duke u ndalur edhe tek detaje si bateristi, gjuha a imazhi. Artisti i njohur shqiptar që ka ekspozuar në galeritë më të mëdha ndërkombëtare, foli edhe për ndjesitë e veta. "Ndiej shpeshherë se ka një imazh të fshehtë, që të lë vend për subjektivitet. Tek disa nga veprat bateristi bëhet i tejdukshëm, kjo për t'i dhënë më shumë vëmendje instrumentit, baterisë... Raportin që kam me gjuhën, që kontrollojnë shumë mënyrën e komunikimit, rrit subjektivitetin e folësit, por redukton subjektivitetin e dëgjuesit apo publikut, të njëjtën gjë e kam edhe me imazhin", tha Sala. Për të ekspozita është një organizëm deri diku i gjallë, ndonëse është i regjistruar.

Për të, përkthimi i punëve në hapësirë, duke qenë se hapësira është shumë e ngulitur në këto punë, është edhe ai moment i përkthimit, kur ai e kam marrë idenë, se si hapësira është ngulitur. "Është pjesë e funksionit dhe e kohëzgjatjes dhe pastaj e rishes atë në hapësirë dhe e ripërkthen këtë raport në kohë, në hapësirë e ekspozitës. Kjo krijon një shtresë të dytë, duke hapur një dritare tjetër, ku në një farë mënyre kontrolli i kalon publikut. Ekspierenca e të qenit midis dy ekraneve është shumë ndryshe nga të qenit përballë dy ekraneve. Fakti që publiku, secili prej tyre është një farë mënyre dirigjent i vetes dhe eksperiencës së vet në hapësirë është një gjë që më intereson shumë", tha artisti.

Për të këta janë skenarë që ai i mendon se si do i donte të ndodhnin - ky takim midis publikut e punëve a ideve, për Salën është edhe një humbje kontrolli, sepse



DEKANATI FAB
organizon:
TAKIM ME STUDENTËT

ANRI
SALA

Ditën e hënë
21 Maj 2018
Ora 10:00
Salla Black Box

© Jutta Benzenberg

Artisti i njohur rikthehet në vendlindje, bashkëbisedon me studentët e arteve



nuk e kontrollojnë deri në fund atë që do të ndodhë me publikun, edhe sjell vulnerabilitetin pak.

HAPËSIRË DHE TINGULL
I pyetur për hapësirën dhe tin-

gullin që gjenden shumë në punët e tij dhe procesi e kërkimit të film-it, Sala tha se "puna ime, ka një ndryshim nga punët e hershme, që ndihet më shumë historia edhe

politika, por që gjithsesi për mua interesi për historinë, për politikën dhe zhvillimet, për mënyrën se si ato janë në marrëdhënie të ndërsjellë midis produkteve kul-

ture dhe momenteve të proceseve historike janë gjëra që më interesojnë shumë". Tha se janë gjëra që është e rëndësishme, që t'i thotë në diskutimet me studentët. Zbuloi se punën "Ravel ravel" nuk do ta kishte arritur anëse nuk do të kishte pasur një interes vërtetë mbi raportin e historisë, të luftës së parë botërore, raportin me humbjen e pjesëve të trupit dhe gjithë kompozimet për dorën e majtë. "E gjithë kjo është si një lloj arkitekture, që unë mundohem pastaj t'i ligjëroj, t'i vë edhe t'i heq nga pjesa e fundit, në mënyrë, që punës t'i mbetet vetëm pjesa e vet e koreografisë dhe mikroklime e vet. Nëse publiku arrin që të shikojë këtë vulnerabilitet, këtë ekuilibër, që është gjithë kohës duke u kërkuar edhe humbur midis dy duarve të majta, interesohet më shumë. Natyrisht që në procesin tim të krijimit ka shumë për t'u lexuar. Ndërsa, për sa i përket interesit të muzikës, më shumë është si diçka që ka zënë rolin e gjuhës, si mjet përcjellje". Muzika për të nuk është fjala apo zëri. Ekspozitën e konsideron si një lloj partiture. Sala tha se e shikon çdo punë dhe raportin midis punëve, si një muzikë dhome. Si një dialog midis disa zërave edhe instrumenteve.

"Një gjë që është e vështirë për ta prezantuar këtu, jo vetëm në Tiranë, është që të gjitha punët janë sterio, por një pjesë shumë e madhe e ekspozimit është mënyra se si përcillet zëri.

Në artin bashkëkohor ne nuk kemi mjete, por përdorim mjete të tjerëve. Në një ekspozitë nuk je si në film, nuk duhet të kesh një raport simetrik me imazhit dhe zërit", tha Sala.

Sipas tij në historinë e muzikës ka ardhur në një moment të caktuar roli i dirigjentit. "Unë jam dirigjenti i ekspozitave të mia, por mundohem që të krijoj ndjesinë, që në fund të fundit është një muzikë dhome, që nuk ka një qendër, por që qendra negociohet edhe që në fund të fundit është individ, vizitori".

ARTISTI

Sala ka fituar Çmimin Vincent (2014), edicionin e 10-të të Çmimit Benesse (2013), Çmimin Absolut Art (2011), dhe Çmimin e Artistit të Ri në Bienalen e Venecias (2001). Ai ka marrë pjesë në shumë ekspozita në grup dhe bienale duke përfshirë Bienalen e Berlinit (2006).

Në 2013, Anri Sala përfaqësoi Francën në Bienalen e 55-të të Venecias me ekspozitën personale Ravel Ravel Unravel.

Anri Sala punon në një mori medimesh që përfshijnë videon, fotografinë dhe instalacionin, është arsimuar në Shqipëri dhe Francë, dhe tani jeton dhe punon në Berlin. Në filmat dhe instalacionet e tij Sala i fton shikuesit të marrin pjesë në botën e tij të vëzhgimit kulturor dhe shpesh përdor si sfond ngjarje socio-politike dhe përvoja personale.



Opinion i Ditës

Nga Xhevat Mustafa

(Vizion nga faja e parë)

... dhe 2". Kuptohet, për kryeministrin përbën edhe një sfidë personale. Arsyja apo llogaria është e thjeshtë. Kapërcimi i saj i mundëson të pasurojë CV-në tij politike dhe qeverisëse me një sukses jo të vogël. Njëkohësisht këtë ai mund ta përdorë gjatë edhe si argument të fortë për t'ia njohur e pranuar edhe si meritë ekskluzive personale dhe ekipore, sidomos në zgjedhjet lokale më 2018 dhe ato parlamentare më 2021. Apo për ta shfrytëzuar në vend e në botë si argument se gjatë qeverisjes së tij, Shqipëria nuk pati "hope" apo "suksese" vetëm në fushat e kanabizimit dhe trafikut të drogave, të ortakërisë së politikës dhe qeverisjes me krimin shumëformësh, të pastrimit të miliardave prej tyre në projekte të mëdha në ndërtim apo kulla, infrastrukturë, turizëm, shëndetësi... Në të kundërt, kryeministri dhe stafet e tij dëshitim në këtë fushatë, pra moshapjen e negociatave në fund të qershorit, larg qoftë jo edhe në fund të dhjetorit 2018, nuk e njeh dhe pranon si humbje personale, ekipore, "rilindase", por më së shumti si keqdashje nga disa qarqe politike të së djathtës në BE. Apo, edhe si rrjedhojë e punës minuese, diskretive apo baltosëse kundër qeverisë "Rama" nga opozita...

Por, duket e kuptohet se vetëlavdërimet për suksese dhe merita, sidomos në fushën e reformave në drejtësi e në luftën kundër kriminalitetit dhe informalitetit nuk po i japin Edi Ramës kartën dhe kënaqësinë që pret, duke i shkaktuar atij nervozizëm të pafsheshëm. Merrren me mend shkaku apo arsyeja. BE-ja, kryesisht Gjermania, Franca, Holanda... edhe pse për diplomaci apo kortezi, i pranojnë disa suksese allashqiptare në këto drejtime, kanë informacion të bollshëm nga Tirana e nga burime në vendet e tyre, se Shqipëria është akoma shumë larg standardeve dhe ka akoma disa detyrime apo "detyra shtëpie" për të kryer, për të marrë me gjysmë zemre dhe zëri, 'OK'-in për hapjen e negociatave. Njëkohësisht edhe se politikanët dhe qeveritarët e Tiranës, sipas një tradite apo zakoni të vjetër, i fryjnë si tullumbace sukseset e tyre të vogla e të pakta, për t'ua shitur atyre si merita të mëdha.

Edhe në takimin me kancelaren gjermane, Angela Merkel, më 25 prill 2018; edhe gjatë vizitës në Francë dhe takimit me presidentin Emmanuel Makron, më 15 maj 2018; edhe në Samitin e Sofjes, më 17-18 maj 2018, kryeministri ynë Edi Rama e përsëriti me dhe pa takt kërkesën e tij se Shqipërisë nuk i duhet vonuar më hapja e negociatave, sepse ai dhe qeveria e tij kanë merita të padiskutueshme se Shqipëria e tij ka bërë "progres befaseshëm" etj., etj. Shkurt e shqip, ai u tha jo vetëm si lypës, por edhe pa e përmbajtur tonin kërcënues, liderëve të vendeve kryesore të BE-së: "Na njihni meritat dhe progresin!". Në nëntëkt kuptohej edhe mesazhi bajat: "Na hapni derën, se përndryshe lidhemi me Rusinë e

Për merita apo për mëshirë?

"...neve si qytetarë na intereson më shumë se Edi Ramës dhe Lulëzim Bashës që Angela Merkel, Emmanuel Makron, Donald Tusk etj., të na njohin 'meritat', sido dhe sado të jenë. Që ata të mos analizojnë dhe kontrollojnë me lupë nëse meritat e Tiranës politike dhe qeveritare janë vërtetë të tilla edhe për tregun politik të Brukselit, Berlinit, Parisit, Vjenës, Amsterdemit..."

Putinit dhe me Turqinë e Erdoganit. Pse jo, edhe me Konferencën e Vendeve Islamike, Kinën..."

Kuptohet se neve si qytetarë na intereson më shumë se Edi Ramës dhe Lulëzim Bashës që Angela Merkel, Emmanuel Makron, Donald Tusk etj., të na njohin "meritat", sido dhe sado të jenë. Që ata të mos analizojnë dhe kontrollojnë me lupë nëse meritat e Tiranës politike dhe qeveritare janë vërtetë të tilla edhe për tregun

shprehur se "ndjeheshin më të pakënaqurit e më të palumturit dhe se kanë cilësinë apo standardin më të ulët të jetesës në Evropë".

Edi Rama, Gramoz Ruçi, Fatmir Xhafaj, Taulant Balla, Ditmir Bushati, Agron Ahmetaj... e kanë bërë gjoksin gropë duke u mburrur për vetingun dhe përgjithësisht për reformën në drejtësi. Por, nëse bëhet një analizë e thellë, e pastër, e ndershme, e paanshme, pra jo allashqiptarsh, do të dalin shumë

Do të ishte më e këshillueshme, më e ndershme, më e pranueshme në qoftë se Edi Rama dhe Ditmir Bushati e vlerësuar si publicist e si skrupuloz në kulturën e të shkruarit në përgjithësi dhe sidomos për drejtshkrimin, gjykoj se Edi Rama nuk ka nevojë për redaktor e korrektor, për t'i dhënë mend se si mund ta formulojë më mirë



politik të Brukselit, Berlinit, Parisit, Vjenës, Amsterdemit... Neve na levdësin që ata të binden dhe ndiejnë keqardhje e mëshirë se nivelin që e reklamojnë qeveria dhe propagandistët e saj, shqiptarë e ndërkombëtarë. Për "frytet" e deritanishme ajo nuk mund të cilësohet dhe pranohet si e suksesshme, e besueshme dhe e përjetueshme. Është fare e thjeshtë dhe e shpjegueshme pse kjo bindje është masive tek shumica e qytetarëve. Sepse nuk ka suksese në ekonomi, në reforma, pa u dukur dhe shprehur në nivelin i jetesës, në mirëqenien e përditshme e të përvitshme të shumicës së qytetarëve, mbijetesa e të cilëve varet nga rrogat, pensionet dhe nga qesharakja "mbështetje sociale".

Dihet mirë se ka rreth 4 vjet që këto janë "harruar" të rriten në fillimvit apo nga 1 prilli, qoftë edhe si rimbursim të inflacionit, rritjes së çmimeve e të taksave. De facto, tek ne kanë qenë dhe janë të tria shumë larg, deri në dhjetë herë më të ulët ta se sa në shumicën e vendeve të BE-së, të cilave guxojmë t'u mbushim mendjen se e meritojmë të jemi bashkë me ata.

kyerkesën e tij për Brukselin. Për mua personalisht dhe subjektivisht, kërkesa e tyre dhe e jona si popull e si vend, do të fitonte më shumë e më lehtë zemra dhe pikë ndërkombëtare mbështetjeje në qoftë se do të shprehej përafërsisht në këtë formë, edhe me pak humor: "Na njihni 'furgonin' me merita e meritëza, por mos na e këqyrni maunen me mosarritje, dëshitime, vonesa, skandale, turpe në vend e nëpër botë, sidomos me trafiket e drogave, bandat e krimeve, vargun e gjatë të koncesioneve, tenderave... As mos e kujtoni pendimin e zhgënjimin tuaj nga mëshira dhe zemërgjerësia e treguar shumë vite më parë me Greqinë, Bullgarinë, Rumaninë, Kroacinë, Sllovakinë... Ashtu si me këta, tregoni keqardhje dhe mëshirë edhe për ne, domethënë për qytetarët shqiptarë, të cilët edhe sipas sondazheve tuaja dalin se janë më të pakënaqurit, më palumturit, më të varfrit në Evropë!"

Duhet të kemi parasysh se ndërta qeveritarët dhe liderët tanë u flasin për merita të shumta e të padiskutueshme, liderët e vendeve dhe institucioneve kryesore të BE-

së nuk befasohen dhe çuditën. Ata kanë informacione të bollshme, të hershme e të freskëta për gjithçka ka ndodhur dhe ndodh, sipas skenarëve ve të vjetër e të rinj, në Shqipërinë e djeshme e të sotme, duke filluar, të paktën nga 12 dhjetori 1990. Kuptohet se janë të mirinformuar se shifrat dhe faktet e qeverive të Tiranës, se përpjekjet e tyre për të reklamuar sa më shumë suksese, fitore, arritje, rritje, përmirësime... nuk mund të merren as si të vërtetë e as të besueshëm. Biles, atyre që janë mbi të pesëdhjetat, u kujtojnë serialin apo malin e "fitoreve" të Enver Hoxhës, deri sa u gremis në ferr:

Prandaj, disa prej tyre mund të thonë me vetë apo me njëri-tjetrin: "Mos na hani kohë shumë për të na mbushur mendjen me meritat tuaja, se i njohim shumë mirë si janë në të vërtetë!". Disa të tjerë mund të ndjehen edhe të fyer me të drejtë. Në këto kushte edhe mund të thonë: "More, për çfarë na pandehin neve këta qeveritarët dhe politikanët e Shqipërisë? Mi-opë apo naivë"? Merrret me mend gjithashtu se ata kanë informacion të bollshëm për faktin se "Rilindja", sidomos në mandatin e parë, u falë mandate dhe pushtete deputeti, ministri, zv.ministri, kryebashkiaku, prefekti, drejtori të përgjithshëm... njerëzve me dosje, me të kaluar, lidhje dhe pasuri kriminale. Merrret me mend se ata, jo vetëm nga gazetarja kurajoze Ambrozia Meta, më 18 maj 2018, e dinë dhe e kuptojnë shumë mirë përse Edi Rama e ka shumë të vështirë të gjejë në gjirin e madh e të pasur të PS-së dy vetë pa asnjë lidhje ose përfolje me trafiket e drogave dhe me krimin e formave të tjera, për ministër të Brendshëm, të Drejtësisë ...

Neve si qytetarë na intereson që Merkel e Makron "të marramenden e mashtrohen", si jo pak shqiptarë, nga "meritat" dhe "lotët e krokodilit" të Edi Ramës, Gramoz Ruçit, Ditmir Bushatit, Taulant Ballës, Lulëzim Bashës, Monika Kryemadhit... për popullin e tyre.

Në të vërtetë, në thellësi, liderët e BE-së nuk mund të mashtrohen, sepse nuk janë as naivë e as pa përvojë në raportet me politikanët dhe qeveritarët e lartë të vendeve të ish-Lindjes Socialiste në përgjithësi e të Shqipërisë, në rreth 25 vjet. Nëse do t'ua japin këtë iluzion dhe kënaqësi qeveritarëve të Tiranës, nëse mund ta bëjnë këtë lëshim dhe të na i hapin negociatat në fund të qershorit 2018, do t'i bëjnë këto për arsyen se ndiejnë sinqerisht keqardhje e mëshirë për "ferrin" që po përjetojnë shumica e qytetarëve të Shqipërisë. Me siguri, mendojnë edhe një avantazh tjetër, që do të ketë hapja e negociatave. Kështu, BE-ja do të ketë mundësi t'i ndihmojë shumë më tepër qytetarët halletmëdhën të Shqipërisë për t'u vënë frerë pangopshëmërisë, pakrupullsisë, papërgjegjshmërisë, mashtrimeve, abuzimeve me ligjin dhe jetët e njerëzve, pandëshkueshmërisë së politikanëve dhe qeveritarëve të të gjitha niveleve në Shqipëri. Pasi të jetë arritur kjo "mrekulli", mund të vijë edhe dita që të flitet seriozisht dhe sinqerisht për merita nga politikanët dhe qeveritarët e Tiranës.

Opinion *i* Ditës

Nga Enkel Xhangoli

Pse protesta e opozitës do të "kurorëzohet" me një tjetër marrëveshje

Në gjithë situatën politike që po kalon Shqipëria, ku e gjithë vëmendja mediatake është zhvendosur në akuzat e opozitës ndaj Agron Xhafajt, vëllait të ministrit të Brendshëm, Fatmir Xhafaj, ajo që vihet re është përpjekja e opozitës që të kapet diku për të marrë veten nga humbja e zgjedhjeve të 25 qershorit 2017. Në këtë mënyrë edhe kreu i PD, Lulzim Basha do të mund të justifikojë pozicionin e tij jo të favorshëm ku ndodhet partia e tij.

Thirrja e tij për protestë në 26 maj personalisht më shumë se sa thirrje për rrëzimin e qeverisë, duket si një thirrje për ndihmë për të ringritur edhe njëherë PD-në si në ditët e lavdishme të saj. Por, a duhet ta besojë populli Bashën pas kaq protestash, ku nuk është arritur asgjë konkrete?

Protesta më e gjatë që ka bërë ndonjëherë opozita ishte ajo e një viti më parë, ku Basha vendosi të qëndrojë për tre muaj në çadër, duke ndërprerë çdo punim në Kuvend apo komisione ku ishte e nevojshme prania e opozitës, por përtej betimeve të Bashës për mosfutje në zgjedhje, ajo protestë u kurorëzua me një marrëveshje mes opozitës dhe PS.

Duke zhvlerësuar kështu të gjithë mundin e demokracisë, të cilët kontribuuan dhe besuan në atë protestë. Lideri i opozitës jo vetëm që humbi besimin në demokratët të cilët e mbështetën, por humbi edhe besimin nga ekspertët të rëndësishëm brenda PD.

Për më tepër, Basha e pastroi qeverinë "Rama" kur futi ministrat teknikë, të cilët nuk denoncuan



asgjë para shqiptarëve, gjë e cila solli rritjen e besimit të PS dhe rënien në PD.

Duke pasur eksperiencën të tillë në politikën tonë, kjo gjë më bën të besoj se edhe protesta e 26 majit do të përfundojë me një kurorëzim marrëveshjeje, të cilën Basha do të mund të thotë u bë për hir të negociatave dhe presioneve të partnerëve ndërkombëtarë.

Për mua është çudi që sa herë

bëhet një marrëveshje mes Ramës dhe Bashës, rinisin ndërtimet e pallateve në Tiranë, të cilët janë lënë pezull për arsye dhe bindje politike. Duke parë rezultatet e protestave të PD është e vështirë që të besosh se protesta e 26 majit do të sjellë ndonjë ndryshim apo rezultate konkrete.

Një tjetër gjë e cila vihet re në këtë protestë është edhe distanca që po mban LSI me kryetaren e saj,

Monika Kryemadhi. Në një kohë që PD po sulmon ashpër qeverinë e Edi Ramës, Kryemadhi përsërit po të njëjta fjalime që prej një viti, duke krijuar një lloj distance apo ftohje nga akuzat e ngritura nga PD. Kjo të bën të mendosh që ose LSI ka një "as nën mëngë", ose marrëdhëniet brenda opozitës po krisen.

Por, diçka mund të them me siguri që Xhafaj nuk do të mund ta "ngrejë" opozitën, kjo gjë nuk ndodhi as me rastin e ish-ministrit të Brendshëm, Saimir Tahiri, ku PD e shfrytëzoi në maksimum, por përsëri pa rezultat, nuk ka për të ndodhur edhe këtë rast, pasi besimi në PD është zbehur.

Sigurisht që protesta e PD do të ketë ndikim, por këtë herë mund të rezultojë shumë negative për hapjen e negociatave në qershor, të cilat mund ta kthejnë Shqipërinë disa vite pas.

Duke renditur disa fakte të thjeshta mund të shikohet lehtë dobësia e opozitës, e cila me gabimet e veta po rrit kredibilitetin e qeverisë "Rama", edhe pse ajo mund të jetë e korruptuar apo e kapur nga krimi. Por besoj që, kur kemi një qeveri të tillë, opozita duhet ta ketë më të lehtë rrëzimin e saj përmes fakteve dhe provave që ajo mund t'i gjejë lehtësisht.

Prandaj mendoj që edhe kjo protestë përveç se do të paralizojë kryeqytetin për disa orë, nuk do të sjellë përsëri rezultate konkrete për rrëzimin dhe demaskimin e kësaj qeverie.

Nga Gazmend Kapllani

(Vijon nga faqja e parë)

...nacionalizmit hysterik, me të cilin është mbrujtur shoqëria greke - që nga krijimi i shtetit modern grek.

Butaris është mbi të gjitha një simbol që urrejnë Kisha Ortodokse Greke, fashistët, stalinistët, kopukët, hajdutët, shteti i thellë grek. Perse e urrejnë? Sepse thotë disa të vërteta të thjeshta si për shembull, flet për holokaustin e hebrejve të Selanikut (një qytet, universiteti i të cilët është ndërtuar mbi varrezat e hebrejve të qytetit); flet për të kaluarën e një qyteti, Selanikut, që dikur ishte një nga qytetet më kozmopolite në Mesdhe dhe që vala e nacionalizmit dhe spastrimeve etnike e ka kthyer në një provincë ku mbizotëron fjala e talibanëve ortodoksë dhe e paranojës nacionaliste.

Por unë, për tjetër gjë doja të shkruaja. Kur isha në Tiranë javën e kaluar, pashe afishe të një koncerti që do jepet në Tiranë, në datën 24 maj, të një këngëtarë grek quajtur Nottis Sfakianakis. Nottis këndon tallava greke, të quajtur në greqisht edhe "muzikë skiladhiko",

Koncerti i ufologut fashist grek, ofendim për shqiptarët



ose në shqip "muzikë qençe" apo "muzikë hum-hum". Nejsë, në një koncert për nazistët e Agimit të lirisë të dëgjojnë dhe të adhurojnë edhe "muzikën hum-hum".

Problemi është se Sfakianakis

është një fashist i hapur, i cili i ka quajtur shqiptarët "plehra", që jep koncerte për nazistët e Agimit të Artë dhe xhit urrejtjen dhe paranojën nacionaliste në Greqi (përveç faktit që është një ufolog,

që beson se grekët janë racë aq superiore, sa që e kanë prejardhjen nga jashhtëtokësorët!).

Më bëri përshtypje që ata që paguajnë 100 apo 200 euro për biletë që ta dëgjojnë, ndërsa në Greqi biletat për koncertet e tij nuk i kalojnë zakonisht 50 euro. Sigurisht, me aq shumë pare të pistë që qarkullojnë në Shqipëri, shumë "plehra", mendoj, s'i kanë për gjë 200 euro për një natë.

Por ajo që të shokon në rastin e atdheut tonë ende-geto është se ne nuk adhurojmë dhe respektojmë vetëm anët më të këqija të vetvetes, por edhe anët më të këqija të tjerëve.

Koncerti i këtij ufologu fashist dhe urrejtje-ndjellës nuk është vetëm ofendim i rëndë për shqiptarët. Është ofendim i rëndë edhe për njerëzit demokratë në Greqi dhe kudo në Ballkan dhe Europë.

* "Pasqyrë.al"

HOROSKOPI

DASHI

Hëna është dembele sot përkundër Plutonit që ju ka në vëmendje. Partnerin do ta keni shumë të dashur, por sot edhe kujdesi që do t'ju tregojë, do t'ju bezdisë. Qëndrueshmëria fizike dhe gjallëria mendore varen edhe nga ajo që hani, kujdesuni për dietën.

DEMI

Do të jeni me miq dashamirës dhe përkrahës, me të cilët do të vendosni të organizoni një aktivitet të bukur. Mes anit dhe natyrës është edhe më e lehtë të bashkëpunosh. Shpenzime të paparashikuara në punë, kompjuteri dhe printeri kanë nevojë për ndërrhyjen e një tekniku.

BINJAKET

Miqët tuaj qjellorë janë Jupiteri dhe Urani, të cilët megjithatë grinden mes tyre. Neptuni dhe Merkuri ju krijojnë ndërlkime. Duke pasur të vështirë të kuptoni se kush jeni dhe çfarë doni në të vërtetë, e keni të vështirë të mbani në kontroll emocionet.

GAFORJA

Dielli dhe Neptuni po ju përkëdhelin, të mbështetur së tepërmi nga Hëna, e cila u jep qëndrueshmëri ëndrrave të juaja. Zgjidhjet, është ende ditë pune, dhe puna po ju thërrret! Për t'ia kaluar mirë, duhet të prisni të përfundoni detyrat.

LUANI

Të ndikuar nga tërheqja e Hënës, keni shumë dëshira, por të gjitha duken se nuk mund të arrihen në një kohë të shkurtër dhe juve nuk ju pëlqen të prisni. Puna është e lodhshme, por ngushëluese. Duke mos u ndalur së kërkuar, në horizont do t'ju shfaqet një ditë.

VIRGJERESHA

Hëna miqësore në bashkëpunim me Plutonin krijojnë situatën ideale për të bërë paqe me partnerin, nëse do të ishte e nevojshme dhe t'iu ktheni përsëri besueshmëri një-tjetrit. Merkuri dhe Neptuni kundra kërkojnë ndërfaqe sqarime, është thelbësore të përballemi në të vërtetë.

PESHORJA

Urani dhe Plutoni po ju shqetësojnë dhe nuk keni çfarë t'i bëni! Planetët e tjerë na-ju paanshmërinë, por duke ju dhënë mbrojtje në angazhimin tuaj. Pozicioni i Diellit, Merkuri dhe Neptuni do të ndikojnë pozitivisht në shëndetin tuaj.

AKREPI

Me fëmijët adoleshentë nuk ka nevojë të mbani fjalime të gjata, ata ju kuptojnë menjëherë, sepse po rriten me të vërtetë. Lexoni libra të mirë dhe do të keni shumë ide për të menduar, talenti krijues ka nevojë për ushqim.

SHIGJETARI

Është dita ideale për ata që kanë dëshirë të bëjnë punime, të shtepi keni me të vërtetë shumë punë për të bërë. Mijet dhe materialet do të jenë të kushtueshme, por do t'ia vlejnjë. Edhe në zyrë atmosfera është e qetë, të gjithë mendojnë për punën e tyre, pa ndërhyrë në atë të tjerëve.

BRICJAPI

Brenda vetes keni forcën e dashurisë. Të qëndrueshëm dhe mendimtar, do të jeni të aftë për të shprehur veten dhe të projektioni drejt së ardhmes. Do të flisni me butësi dhe delikatesë, gjitha që përdorni është romantike, që vjen nga zemra.

UJORI

Do të keni tensione të vogla në familje. Do të ngushëlloheni duke blerë disa gjëra të vogla, jo ndonjë gjë kushtesh se çfarë, por t'ju shpëton nga gjërat kulturore për t'iu koleksionuar. Do të bëni shumë shpenzime ushqimore sot, duke u treguar të kujdesshëm për atë që blini, sepse shëndeti fillon që nga tryeza.

PESHQIT

Do të jetë një ditë bashkëbisedimesh dhe hapje zemre. Nëse një histori është ende në ekulibër midis miqësisë dhe dashurisë, duhet të jeni ju ata që duhet të vendosni për rrijedhen e mëtejshme të gjërave. Beqarët do të t'u përkushtohen romancave artistike.

BOTËTORI 2018.



Skandal dopingu te përfaqësuesja e Ruisisë?

Kombëtarja e Ruisisë, vendit organizator të Kupës së Botës, që nis në muajin qershor, rrezikon të përfshihet nga një skandal shumë i madh. Futbollistët e saj dyshohen se kanë përdorur doping, një lajm i publikuar nga prestigjiozja gjermane "Bild".

Gjithçka zbulohet nga një dokument, ku bëhet e ditur se mes 155 mostrave të kapura nga Agjencia Botërore Anti-Doping (WADA), në laboratorin e kontrollit të Moskës, janë edhe mostrat e lojtarëve aktualë të kombëtare ruse. Sipas FIFA-s, procesi i kontrollit

është në vazhdim dhe rezultatet pritet të dalin javët e ardhshme. Do të ishte vërtet një mega skandal, nëse lojtarët e Ruisisë do të dilnin pozitivë në këto teste, ndërkohë që më 14 qershor nis Botëtori. Dyshimet janë ngritur prej kohësh. WADA ka

përcjellë të dhënat përkatëse në FIFA dhe pritet përgjigja. "Ajo që mund të them është se kemi dyshime dhe presim tani përgjigjet e testeve. Ne do të jemi shumë vigjilentë, që gjithçka të jetë transparente", - tha shefi i WADA-s, Gunter Younger.

Trajneri brazilian i bardhebluve vlerëson sezonin e tij të parë te kryeqytetasit

Ze Maria: Dua të qëndroj te Tirana

Por pranon se nuk ka akord me presidentin

Tirana ka arritur të fitojë Kategorinë e Parë dhe në sezonin e ardhshëm do të rikthehet në Superiore. Trajneri Ze Maria është duke menduar për ngjitjen në elitën e futbollit shqiptar, por, nga ana tjetër, mundohet të bëjë vlerësimin e këtij sezoni që lamë pas. I ftuar në "E hëna sportive" që transmetohet në "RTSH", trajneri brazilian është shprehur se puna e tij më e vështirë në këtë klub ka qenë në anën psikologjike, ndërsa në Kategorinë e Parë kundërshtarët jepnin më shumë nga vetja e tyre, për të arritur në një klub të nivelit të lartë. "Nuk është asnjëherë e lehtë, e kam gjatë gjithë vitin që skuadra që kërkojnë ta mundnin. Kundërshtarët që zbrisnin në fushë jepnin maksimumin e tyre, ndoshta pak më shumë nga çfarë mundin, për të rënë në sy të Tiranës apo një tjetër klubi në Superiore. Futbollistët kanë qenë të përqendruar në gjithë kampionatin. Kasrioti ka krijuar 2-3 raste që mund të shënotë. Lojtarë si Karabeci, Daja dhe Lika që kanë një histori të madhe, nuk është e lehtë që të rikthehen me të njëjtën dëshirë në Superiore. Kemi folur shumë me stafin, për t'iu rikthyer besimin që humbën në Kategorinë e Parë. Futbollistëve duhet t'u rikthehej besimi, pasi nuk ishte problemi në fushën e lojës, por në mënyrën e të menduarit. Nëse gabonin faji do të ishte i imi, jo i lojtarëve. Ua kam thënë se nëse gaboni me vendimet që unë u them, atëherë është problemi im. Kur kam ardhur te Tirana më kanë shpjeguar historinë e klubit, pasi nuk e njihja. Kam ndierë presion në Shqipëri, por unë vijë nga eksperiencia si Italia dhe Spanja, ku presioni ka qenë akoma më i lartë. Mund të them se jemi pak a shumë si Juventus, se është skuadra me më shumë tituj këtu dhe Juventus ishte e tillë kur ra në B. Kanë kaluar pak a shumë të njëjtat probleme. Unë kuj-



toje ende në aeroport, një gazetar më bëri pyetjen a duhet të rikuperoj si Juventus. Juventusit fitoi titullin e 7 tani. Por Tirana është një

skuadër që ka treguar tashmë se i ka letrat në rregull për të luajtur në Superiore. Kam thënë gjithmonë që me presidentin nuk kam asnjë

probleme për të folur, gjithçka. Jemi shumë të hapur kur flasim e të drejtpërdrejtë. Kemi folur pak, jo për kontratën, nuk është ky prob-

lemi. Kur kam folur me presidentin për gjëra që ju i dini, i kam thënë më intereson të trajnoj Tiranën vitin e ardhshëm. Pjesa tjetër janë detaje që duhet t'i sqarojmë para se të shkoj me pushime. Ende nuk janë sqaruar, por e përsëris që nuk do të ketë probleme. Detajet janë normale, në skuadra të mëdha, detajet janë më të mëdha, objektivat janë të mëdha. Edhe pse luanim në Kategorinë e Parë, kemi luftuar deri në fund, shkuam në çerekfinale të Kupës se luajtëm me një lojtar më pak për shumë minuta. Por kemi luajtur, fituam Superkupën dhe kampionatin. Për të luftuar për titullin duhet diçka më shumë se çfarë kemi, për t'u përballur me skuadrat e një niveli më të lartë", -ka thënë Ze Maria.

ARGJENTINA



Sampaolo lë jashtë botëtorit Mauro Icardin

Një natë më parë, Mauro Icardi shënoi një nga golat që kthyen Interin në Ligën e Kampionëve pas 6 viteve mungese në atë turne. Por gëzimi sot është kthyer në dëshpërim pasi sulmuesi zikaltër ka mësuar se këtë verë do të ndjekë Rusi 2018 si spektator. Futbollisti ishte në listën paraprake të Argjentinës për aktivitetin në fjalë, por sipas mediave argjentinase, emri i tij nuk gjendet në listën përfundimtare që do të bëhet publike sot pasdite nga trajneri Jorge Sampaolo. Ky i fundit ka lënë jashtë edhe shokun e ardhshëm të skuadrës të Interit, Lautaro Martinez, ndërsa kishte vend në këtë listë për dy futbollistët e Juventusit, Higuain dhe Dibala. Surpriza e vërtetë në listën e Argjentinës për shumëkënd është prania me 23 lojtarëve e futbollistit të Torinos, Ansaldo.

LISTA

Portierë: Romero, Kabajero, Armani
Mbrojtës: Merkado, Salvio, Fazio, Otamendi, Ansaldo, Taljafiko, Akunja, Roho
Mesfushorë: Mascerano, Banega, Bilja, Di Maria, Lo Celso, Meza, Lanzini
Sulmues: Pavon, Mesi, Dibala, Higuain, Agüero

ÇMIMI

Abazaj vlerësohet si "Talent i Sezonit"

Është organizuar dje, edicioni i 10-të i ndarjes së çmimit "Talent i Sezonit". Shoqata Gazetarëve "Sporti na Bashkon" ka vlerësuar me çmimin "Talent i Sezonit", në vendin e parë, Kristal Abazajn. Sulmuesi i Luftëtarit ka bërë një sezon fantastik duke qenë një ndihmë e madhe për bluzinjët të cilët siguruan pjesëmarrjen në Europë. Në vendin e dytë si talenti më i mirë i sezonit në Superligë u rendit Esat Mala. Mesfushori shkëlqeu me Partizanin. Në vendin e tretë u renditën: Jurgen Bardhi (Partizani), Gentian Selmani (Laçi) dhe Esin Hakaj (Teuta).




PORTIERI

Bufon firmos të mërkurën me Paris Sën Zhërmen

Ka të reja në lidhje me të ardhmen e portierit Khan Luixhi Bufon, i cili pak ditë më parë i dha lamtumirën Juventusit. U duk fillimisht edhe një lamtumirë nga futbollit i luajtur, por më pas, për shkak të ofertave të shumta, Bufon vendosi të mos tërhiqet. PSG-ja e ka shumë seriozisht për portierin italian, që duket vetëm një hap larg Francës. Kanë mbetur për t'u saktësuar disa detaje të fundit dhe pritet që deri të mërkurën të jetë mbyllur gjithçka mes portierit veteran dhe klubit francez. Firma në kontratën e re do të jetë deri në vitin 2020 dhe me shumë mundësi do të hidhet ditën e mërkurë.



Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Mund të jetë një arkë.
- 8. Fillojnë ndeshjen
- 9. Paul që këndonj Diana.
- 10. Spagna që këndon ën Itali.
- 13. Fillojnë lojën.
- 14. Gjysmë tepsie
- 17. Mund të jenë ekspres.
- 18. Qe babai i mjekësisë.
- 21. Eshhtë si ballon.
- 22. Lind një në kokë.
- 24. Janë ministri.
- 25. Pak normalitet.
- 26. Një pjesë e edukatës.
- 27. Inicialet e Asimov.
- 28. Eshhtë e vrara në kufhtë.
- 30. Iglitë Lazio.
- 31. Inicialet e Redford.
- 33. Mbetet në fund.
- 34. Pak analogji.

- 35. Eshhtë vdekje e autorizuar.
- 39. Një numër femrash.
- 42. Në krye të modernistëve.
- 43. Kërkojnë talent.
- 44. Mbetet në fund.
- 45. U vra me një grushngn nga Odiseu
- 47. Bëhet në start.
- 49. Catherine aktore.
- 50. Ishte babai i Odiseut

VERTIKAL

- 1. I famshëm ai i Trojës.
- 2. Një...FIAT.
- 3. Mbyllin një hark.
- 4. Eshhtë si sarkazmë.
- 5. Fillojnë ideologjinë.
- 6. Ushtrohet me cd false.
- 7. Në këtë moment.
- 8. King Cole i muzikës.
- 11. Janë si cilësi.
- 12. Fillojnë nazet.
- 15. Flet për bëmat e kreshnikëve.
- 16. Janë shërbimet me... korrespondencë.
- 17. Janë binarët.
- 18. Nënkuptojnë edhe pranga.
- 19. Aktet pa kufij.
- 20. Itakojnë fituesit.
- 21. Quinn aktor.
- 22. Pak inekzistente.
- 23. Fillojnë dobët.
- 24. Rrjeshtohen në kuvëntë.
- 29. Eshhtë divorci.
- 32. Një pije piratësh.
- 33. Zamore për perime.
- 36. Një pesk i rëndë.
- 37. Enti amerikan i hapësirës.
- 38. Yll anglez.
- 40. Gripi paa ekstreme.
- 41. Tiran pa kufij.
- 46. Në hyrje të oazit.
- 48. Fillojnë ilustrimet.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Marple a Agatha Christie.
- 4. Zanore për zulu.
- 6. Qyteti i Protagora-s.
- 11. Inicialet e Lendl ish tenist.
- 12. Janë tek në kufij.
- 14. Benigni aktor.
- 16. Mund të jetë me mbret.
- 18. Gjysmë ndikim.
- 20. Një dru aromatik.
- 21. Tekë trari.
- 23. Janë me numër të tilla ushtarake.
- 24. Nusja pa çifte.
- 25. Iglitë Lazio.
- 26. Një pjesë e sipërfaqes.
- 27. Një fjalë... para kohe
- 28. Janë mashtrime... me grim.
- 31. Duken të gjata në prijte.
- 32. Skuadra merengue.
- 33. Eshhtë trofe sportiv.
- 34. Ndahen nga ortakët.


- 36. Një biçikletë dyshe.
- 39. Kalohen në gjurmë.
- 42. Kanë dhoma për t'u zënë.
- 44. Një treshe në skenë.
- 46. As unë, as ai.
- 47. Aq duhet t'i bëjnë sytë vigjilentët.
- 48. Gjysmë armate.

VERTIKAL


- 1. Një legjendë.
- 2. Përfundojnë një stil.
- 3. Shkruhen për filma.
- 5. Janë malet ruse të tilla
- 6. Agjenci Botuese Lokale.
- 7. Një kontestues i viteve shatëtdhjetë.
- 8. Në krye të drejtuesve.
- 9. Eshhtë racë kombi.
- 10. Steiger aktor.
- 13. I vihen kalit.
- 15. Një britmë në corrida.
- 16. Një gjellë gratis.
- 17. Rolet pa zë.
- 19. Eshhtë e hollë dhe therëse.
- 20. Një brejtës pylli.
- 22. Janë pamje nga puna.
- 26. Janë aksione për gol.
- 27. Janë maskarenj.
- 28. Tre në tetëdhjetë.
- 29. Emri i parë i Fassbinder.
- 30. Fillojnë turnin.
- 32. Kupa e fituar gjithmonë nga Brazili.
- 34. Eshhtë Organoziata e skuadrave të Formula 1.
- 35. Mbyllin punimet.
- 37. Ndoch në kufij.
- 38. Një përthure.
- 40. Pak tradicionale.
- 41. Një cigan.
- 43. Fillojnë lehtë.
- 45. Mbyllin një manastir.



Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave

SUDOKU

1								3	
	2	3			1			9	6
5	7			4					
4	3		6	2					5
6			4						
			8			1			
		7		3	4				
		9		6				7	3
			5						

Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar

7	6	3	1	9	2	5	8	4
2	4	8	3	5	6	9	7	1
5	9	1	7	4	8	6	2	3
3	2	7	5	6	9	4	1	8
4	5	9	8	2	1	7	3	6
8	1	6	4	7	3	2	5	9
6	3	5	2	1	4	8	9	7
9	8	2	6	3	7	1	4	5
1	7	4	9	8	5	3	6	2

Argëtim filozofik

- Njeriu kur ndjen dhimbje, është i gjallë... Por kur ndjen dhimbjen e tjetrit, atëherë është NJERI.
- Forca shpirtërore s'është gjë tjetër, veçse arti për të mbajtur mbyllur në zemër shqetësimin.
- Nuk ka rëndësi kush të zhgënjue, apo kush të rrëzoj, rëndësi ka kush të bëri të buzëqeshësh sërish.
- Mos ndiq askënd... një person që të vlerëson ecën përkrah teje.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME
Përgjigja e numrit të djeshëm

e4	19	5	6		4	6		6	1	4	1	7	
1	15		11	8		8	6		5	L	I	M	A
17		14	8	5	8	12	1	7	8	7		5	
	6	3	7	9	6	1	13	8	7		14	8	
17	9	6	19	13	3	7	3	7	3	7		13	
9	16	8	15	1	7	9	15	8	7		7	7	
			13	3		8	13	9		12	1		
16		4	13	13	3		6	1	5	5	3		
1	6	3	1	13	7		17			9	4	8	
13		9	7		8	17	3	16	9	15	8		
3	7	15		8	7	3	5	8	13	3		8	
17	15	3	6	3		4	3	15	7	1	17	3	

S	R	S	E	R	I	K	O	D	A	K	
T	A	T	A	M	I	S		R	R	I	
I	I	H	I	P	O	T	E	Z	A	T	
N	P	A	R	A	K	A	L	I	M	E	T
A	N	E	T	A	R	E	T	L	A	A	
				R	I	T	I	O	I	T	A
A	T	E	E	M	R	A	I	R	O		
K	E	N	E	T	E	I	T	A	K	A	
T	K	D	T	A	A	N	T	A			
O	T	I	T	I	G	R		T	K		
R	U	M	I	S	I	O	N	A	R	E	T
E	K	S	T	R	E	M	I	S	T	E	T

PËRGJIGJET E FJALËKRYQJEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)

L	A	U	R	A	K	O	H	A	A	P		
V	O	L	T	A	D	O	G	A	N	A	R	
A	R	I	E	M	I	M	R	A	N	S	E	
D		P	E	R	I	T	A	T	I	M		
U	H	P	A	R	E	T	I	M	E	T	I	
Z	E	M	E	R	A	K	E	T	S	T	I	
E	I	D	A	N	E	T	V	E	T	E	M	
S	E	N	A	T	I	I	B	E	R	I	K	E
S	E	N	E	K	A	L	L	A	P	A	T	
T	R	E	E	L	S	A	T	T				
L	I	V	E	T	A	K	A	A	D	E		
N	A	A	R	N	J	E	A	P	E	L		

FJALËKRYQI (2)

B	A	Z	A	R	V	A	K	A	N	T	E
E	D	E	N	P	N	A	D	I	A	L	
S	R	E	P	I	T	E	T	T	R	I	O
T	E	S	T	R	T	A	T	E	O	L	
S	M	N	O	T	A	R	E	T	N	A	
K	A	A	M	E	R	I	K	A	N	E	
E	H	F	A	M	A	D	S	H			
K	O	L	O	N	A	K	T	E	C	E	
T	U	N	E	L	E	T	R	E	R	O	S
E	R	A	I	T	K	E	S	T	I	A	
T	A	N	S	A	R	A	H	E	P		
E	T	A	I	K	A	T	E	T	E	T	I

Thënie të mënçura

- - Njëqind vite të jetës së një njeriu që nuk merr në konsideratë Ligin Suprem , është e krahaseshëm vetëm me 1 ditë të jetës së atij që e respekton .
- - Eshhtë e preferueshme të mos bëhet një vepër e bërë keq , sepse më pas do
- - pendohemi . Atë që bëjmë , më mirë ta bëjmë të rrëgullt (mirë) , për të mos u penduar .
- - Urrëjja nuk ndalet nga urrejja , në asnjë kohë ; urrejja pushon nga dashuria : ky është ligji i përjetshëm .

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

www.gsh.al

GAZETA SHQIPTARE

GSH.AL

GSH

www.gsh.al

- Na merrni!
- Na shkruani!
- Na lexoni!

Tashmë edhe lundroni!

